



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28 regjistër (JR)
Datë 24.05.2019

Nr. 26 i vendimit
Datë 15.10.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.10.2020, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Çlirim Shahini, prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 124, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kodi i Procedurës Civile, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 124, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe

konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Çlirim Shahini (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit/drejtuës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Ai i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës.
2. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Prokuroria e Përgjithshme. Konkretisht:
 - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se:
 - i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të figurës, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, ka dërguar raportin e rishikuar me konstatimin për *papërshatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e ushtrimit të detyrës².
 - 2.3. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³.
3. Komisioni e bazoi vendimmarrjen e tij vetëm në dy kritere të procesit të rivlerësimit, të pasurisë dhe të figurës, me argumentin se provat për këto kritere kishin nivelin e provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës. Në vendimin e tij, Komisioni shprehet se vendimmarrja për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit profesional.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Me vendimin nr. 124, datë 26.03.2019, Komisioni vendosi *shkarkimin nga detyra* të subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini.
5. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, Komisioni vlerësoi se:

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 06.02.2018.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 16.08.2018.

³ Paragrafi 8 i vendimit të Komisionit.

5.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter. Me shpjegimet dhe provat e paraqitura, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë e rezultateve të hetimit. Në zbatim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, u zbatua prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

5.2. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta, përcaktuar nga neni Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklaramit, nuk ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germës “ç” të pjesës 5 të “Shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, parashikuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka renditur në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme sipas nenit 38, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

5.3. Në përfundim të analizës së ankesës së z. B. Ç., në vlerësim tërësor edhe të dy kriterëve — të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës — subjekti i rivlerësimit ka cenuar rëndë besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

6. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vendosi se subjekti i rivlerësimit:
- nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës;
 - ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose për të evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës;
 - ka bërë deklaram të pasaktë sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë, duke u përpjekur të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
 - ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;
 - ka cenuar rëndë besimin e publikut te drejtësia, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit⁴ më datë 17.05.2019, mbështetur në nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin F të Aneksit të Kushtetutës, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim “K.Pr.Administrative”), Kodi i Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”) dhe në nenin 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).
8. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ka për objekt: *Kalimin e çështjes objekt ankimi në seancë gjyqësore publike. Vazhdimin e hetimit administrativ edhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Çlirim Shahini. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 124, datë 26.03.2019, dhe konfirmimin në detyrë të*

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.04.2019, Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit njoftimin e vendimit. Në fletën e lajmërim marrjes së postës, është shënuar data e dorëzimit më 06.05.2019. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është regjistruar në Komision me nr. {***} prot. Me vendimin nr. 124/1, datë 20.05.2019, Komisioni vendosi pranimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit.

subjektit të rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, me detyrë prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit:

- gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike;
- ndryshimin e vendimit nr. 124, datë 26.03.2019, të Komisionit; dhe
- konfirmimin e tij në detyrë.

9. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit fokusohen kryesisht në pretendime që lidhen me shkeljen e parimeve procedurale dhe pretendime që lidhen me vlerësimin e kriterëve.
10. Lidhur me pretendimet për shkelje të parimeve procedurale, subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit si të pambështetura në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe kuadrit ligjor shoqëruar, të arritura në kushtet e mosmarrjes në konsideratë të të gjitha provave të paraqitura gjatë hetimit, ashtu edhe pasi iu kalua barra e provës. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave dhe vazhdimin e hetimit administrativ për kriterin e tretë të procesit të rivlerësimit që lidhet me aftësitë profesionale. Subjekti parashton në mënyrë të përmbledhur pretendimet e mëposhtme.
 - a. Komisioni ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe neneve 4, pikat 5 e 6 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke vendosur përfundimin e hetimit administrativ dhe kalimin e çështjes në seancë dëgjimore vetëm për dy kriterë, atë të vlerësimit të pasurisë dhe të figurës.
 - b. Komisioni nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për kërkesat e subjektit të rivlerësimit lidhur me marrjen e provave që janë kërkuar pas kalimit të barrës së provës, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, neneve 49, pika 9 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 183 të K.Pr.Civile.
 - c. Sjellja e trupës gjyqësore të Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në referim edhe të jurisprudencës së GjEDNj-së, pasi është e njëjta trupë që edhe heton, edhe gjykon faktet.
 - ç. Në procedurën e ndjekur nga Komisioni, ka elemente të theksuara të paragjyqimit, si dhe shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë e të një vendimi të paracaktuar, gjë që vë në dyshim serioz pavarësinë dhe paanshinë e gjykatës.
 - d. Komisioni ka dalë nga misioni kushtetues dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur standarde të dyfishta në raste të ngjashme, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në pozita diskriminuese.
 - dh. Interpretimi dhe vlerësimi i konstatimeve nga ana e Komisionit është përtej synimeve dhe qëllimeve të kuadrit ligjor e kushtetues dhe jo në frymën e gjithë procesit të reformës në drejtësi.
 - e. Komisioni nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor në kuptim të neneve 4, pika 5 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, ka treguar një nxitim të pashpjegueshëm në caktimin e seancës dëgjimore dhe nuk ka marrë në shqyrtim provat dhe shpjegimet e dërguara më datë 14.03.2019.
 - ë. Komisioni nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave duke e kthyer seancën dëgjimore në formale, në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59 dhe 87, pika 2, shkronja “ç” e K.Pr.Administrative, si dhe me pikat 10 e 11 të aktit “Hapat procedurale të unifikuar”.
11. *Për kriterin e kontrollit të figurës* - subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimet e DSIK-së dhe hetimin administrativ të Komisionit, si të mangët dhe dashakeq. Subjekti i rivlerësimit kërkon plotësimin e hetimit administrativ dhe konstatimin se ka kryer deklaram të

mjaftueshëm, ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, dhe nuk ka asnjë kontakt me persona të papërshtatshëm apo të përfshirë në krimin e organizuar, duke u vlerësuar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Subjekti i rivlerësimit kërkon kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim administrimin dhe vlerësimin e provave bashkëlidhur, vendimin nr. {***}, datë 09.06.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, si dhe marrjen e akteve nga autoritetet greke të drejtësisë për të dokumentuar veprimtarinë kriminale në këtë shtet të z. N. (A.) D..

12. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë* – subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit pasi, sipas tij, nuk ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Përpos pretendimeve që lidhen me procesin e rregullt ligjor në vlerësimin e këtij kriteri, një pjesë e të cilave janë trajtuar edhe më lart, subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni ka arritur në përfundime të hamendësuar pasi nuk ka marrë në konsideratë konkluzionet e ILDKPKI-së, nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e tij, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjvënësit, të ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës. Sipas çështjeve të trajtuara për këtë kriter, në mënyrë të përmbledhur, subjekti parashtron sa vijon:

12.1. *Lidhur me personin tjetër të lidhur [z. D. R.]* – analiza financiare mbi burimin e të ardhurave për ndërtimin e godinës 3-katëshe në vitin 2001 nuk është e saktë. Z. R. nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme. Fotot dhe videoja e depozituar janë bërë nga subjekti i rivlerësimit për të treguar tri ambientet që ai disponon, që janë: dy kate + papafingo, ku në njërin prej kateve banon vetë me familjen gjatë periudhës së gushtit, kati tjetër është dhënë me qira vjetore të z. I. J., ndërsa kati papafingo prej 107 m² është i papërfunduar.

12.2. *Lidhur me kohën e ndërtimit të objektit* – koha e ndërtimit është dhjetor 2013 – dhjetor 2014. Në mënyrë dashakeqe Komisioni nuk është mbështetur në provat e paraqitura prej tij. Subjekti kërkon kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim administrimin e vlerësimit e provave bashkëlidhur, pasi debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar pretendimet se vendimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, ashtu edhe gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë nga Komisioni.

12.3. *Lidhur me huan në vlerën 2.720.324 lekë ndaj shoqërisë “{***}” ShPK* – flitet për një marrëdhënie detyrimi mes palëve e dokumentuar ndër vite, shumat e shlyerjes së detyrimit janë deklaruar rregullisht dhe nuk ka pasur qëllim të fshehtë pasurinë apo burimin e krijimit të saj.

12.4. *Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “{***}”⁵ ShPK* – z. D. P. ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të dhënë huan në vlerën 35000 euro dhe argumenti i Komisionit për mungesë të të ardhurave për shkak të mosshpërndarjes së fitimit në formën e dividendit të shoqëria nuk qëndron.

13. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendime edhe për mospasqyrimin e tepricave *cash* në deklaratat e interesave vjetorë/periodikë. Sipas tij, kjo ka ndodhur për shkaqe *pakujdesie*, pasi janë konsideruar si teprica që nuk e kalonin vlerën 1500000 lekë, por burimi i të ardhurave ka qenë i mjaftueshëm, referuar edhe raportit të ILDKPKI-së.

14. *Për cenimin e besimit të publikut të drejtësisë* – parashikimi i pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr.

⁵ Në ankimin e tij (faqe 26), subjekti i është referuar shoqërisë “{***}” ShPK, ndërkohë që detyrimi ka qenë ndaj shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK.

84/2016 nuk aplikohet kur mungon vlerësimi tërësor dhe kumulativ i të tria kriterëve. Nëse do të qëndronin, konkluzionet e Komisionit nuk janë të atilla që evidentojnë sjellje që cenojnë besimin e publikut. Për më tepër, Komisioni nuk ka pranuar ta marrë në shqyrtim kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Lidhur me ankesën e z. B. Ç., subjekti i rivlerësimit sqaron se çështja është hetuar prej tij në mënyrë korrekte dhe me objektivitet, dhe mangësitë e pasqyruara nga Komisioni nuk kanë ndikuar në zgjidhjen ligjore të çështjes penale.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

15. Ankimi i subjektit të rivlerësimit u mor në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi në bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.
16. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”)⁶ mori fillimisht në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, e artikuluar disa herë prej tij, si në objektin dhe në kërkimin përfundimtar të ankimit, ashtu edhe në parashtrimin e pretendimeve që lidhen me shkelje të parimeve procedurale, si dhe me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës e të pasurisë.

16.1. Në analizë të kërtimeve të subjektit për administrim provash të reja, shtjelluar më sipër në paragrafin 11, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi së pari se vendimi nr. {***}, datë 15.12.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë⁷, bashkëlidhur ankimit nga subjekti i rivlerësimit, rezulton i administruar nga Komisioni si pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Ky fakt nënkupton që Komisioni ka qenë i njohur me çfarë subjekti kërkon të provojë me këtë akt. Për më tepër, dijenia e Komisionit del qartë edhe nga rezultatet e hetimit administrativ, të cilat i janë bërë të njohura subjektit të rivlerësimit më datë 27.02.2019. Konkretisht, në faqen 30, pika 2 që i përket gjetjeve të Komisionit mbi kriterin e kontrollit të figurës, referohet edhe ndryshimi i vendimit në fjalë të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e apelit.

16.2. Së dyti, ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës penale nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, për sa i përket z. N. D. është i parëndësishëm për të provuar padijeninë e subjektit për përfshirjen e këtij individi në veprimtari kriminale para dhe pas vitit 2013 – kohë kur subjekti ka përdorur për udhëtim personal jashtë shtetit automjetin z. D.. Me fjalë të tjera, ndryshimi i cilësimit të veprës penale në apel nuk mund të provojë përjashtimin e subjektit nga përgjegjësia e mosplotësimit me vërtetësi të formularit të kontrollit të figurës.

⁶ Trupi gjykues është rezultat i shortit të datës 28.07.2020, për zëvendësimin e gjyqtarit Luan Daci, i caktuar anëtar në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit. Zëvendësimi i gjyqtarit Luan Daci është bërë për shkak të pezullimit të tij nga detyra me vendimin nr. 14, datë 24.07.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve. (<http://kpa.al/njofitime-7/>). Pas hedhjes së shortit, gjyqtarin Luan Daci e ka zëvendësuar gjyqtarja Natasha Mulaj.

⁷ Vendimi ka për objekt kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. {***}, në ngarkim të të pandehurve S. A., N. D., S. M. dhe F. M., të dënuar për veprën penale të ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit në bashkëpunim dhe përsëritje, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal. Në vendimin e gjykatës pasqyrohet dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër (nr. {***}, datë 09.06.2009) dhe Gjykatës së Lartë (nr. {***}, datë 20.10.2011). Sipas shënimit të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë: i) Gjykata e Apelit Gjirokastër ka lënë në fuqi vendimin lidhur me të pandehurit S. M. dhe F. M. dhe ndryshimin e vendimit për dy të pandehurit e tjerë. Ndër ta, edhe deklarinimin fajtor të N. D. për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror. Për të pandehurit N. D. dhe F. M. është urdhëruar nga gjykata lirimi i menjëhershëm i tyre. ii) Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin e ushtruar nga Prokuroria e Apelit Gjirokastër dhe nga i pandehuri S. A. ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

16.3. Së treti, marrja e informacionit nga autoritetet greke të drejtësisë – kërkuar nga subjekti i rivlerësimit⁸, për të dokumentuar veprimtarinë kriminale në Greqi të z. N. D., përpara vitit 2008 – në shqyrtimin tërësor të çështjes konsiderohet e panevojshme dhe e papërshtatshme për ekonominë gjyqësore, në kushtet kur Komisioni ka administruar mjaftueshëm të dhëna lidhur me dy procedime penale të këtij individ në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht në vitin 2008 dhe në vitin 2014⁹.

17. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, gjerat “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016, vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja dhe ta vazhdojë gjykimin e kësaj çështjeje në dhomë këshillimi. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore publike nuk u pranua, pasi u konstatua se mungojnë kushtet e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, gjykimi vazhdoi mbi bazën e akteve të depozituara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, në fashikullin e çështjes.

B. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me shkelje të parimeve procedurale

18. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor në kuptim të neneve 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe neneve 4, pikat 5 e 6 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të respektimit të parimeve të procesit dhe respektimit të të drejtave të subjektit të rivlerësimit.* Komisioni ka vepruar në shkelje të rëndë të procesit të rivlerësimit, gjë që e bën procesin e parregullt, pasi ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ dhe të kalojë çështjen në seancë dëgjimore vetëm për dy kritere, atë të vlerësimit të pasurisë dhe të figurës, duke mos qenë në kushtet ligjore të përfundimit të procesit pa ezauruar edhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga hetimi administrativ nuk u konstatuan pasuri të fshehura, deklarime të rreme, burime të paligjshme të pasurisë dhe Komisioni duhet të revokonte vendimin për përfundimin e hetimit administrativ dhe të kryente një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Provat e paraqitura gjatë procesit provojnë se ai ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe të kontrollit të figurës.

18.1. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor rezulton të jetë artikuluar në çdo argumentim që lidhet me shkeljen e parimeve procedurale. Për të qenë garantist në trajtimin e pretendimeve të subjektit për cenim të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues i Kolegjit ka shqyrtuar procedurën e ndjekur nga Komisioni gjatë procesit që lidhet me subjektin e rivlerësimit në raport me parashikimet kushtetuese, parimet e standardet ndërkombëtare dhe aktet ligjore e nënligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve. Në analizë të këtyre burimeve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka përmbushur detyrimet për të siguruar proces të rregullt ligjor për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me garantitë kushtetuese dhe parashikimet e nenit 6 të KEDNj-së. Subjekti ka marrë pjesë aktive në proces dhe ka parashtruar argumentet e tij. Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 46, 55 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka njoftuar dhe ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektin e rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, i ka siguruar subjektit të rivlerësimit të dëgjohej në seancë dëgjimore, si dhe ka arsyetuar me shkrim vendimin e tij për dhënien e masës disiplinore për shkarkimin nga detyra

⁸ Shih paragrafin 11 më sipër.

⁹ *Procedimi penal i vitit 2014 [nr. {***}, regjistruar më datë 09.12.2014] për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të z. A. (N.) D., i pushuar më datë 19.06.2015 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me shkresën nr. {***} prot.*

të subjektit. Procesi i rivlerësimit të subjektit është zhvilluar përgjatë një periudhe gati njëvjeçare, duke filluar nga hedhja e shortit, më 15.03.2018, fillimi i hetimit administrativ më datë 22.03.2018 dhe përfundimin e tij më datë 26.02.2019. Subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatet e hetimit më datë 27.02.2019 dhe ka sjellë prapësimet e tij përkundër rezultateve të hetimit, si dhe ka argumentuar parashtrimet e tij para Komisionit, më datë 21.03.2019. Aktet në fashikull tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka komunikuar në mënyrë aktive me Komisionin, është njohur me aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ka dhënë shpjegime dhe ka vënë në dispozicion akte e dokumente në cilësinë e provës, në përgjigje të pyetësorëve dhe pas kalimit të barrës së provës ¹⁰.

18.2. Nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton se Komisioni i ka dhënë subjektit të gjitha mundësitë dhe garancitë për t'u mbrojtur, duke i dhënë të drejtën të paraqesë shpjegime dhe deklarata në lidhje me: i) vlerësimin e provave, ii) rezultatet e hetimit dhe iii) rezultatin e mundshëm të procedurës së rivlerësimit. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt të mundshëm interesi me anëtarët e trupit gjykues, të ketë kërkuar përjashtimin e ndonjë anëtari, apo që ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues të ketë kërkuar heqje dorë, gjë që mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues kanë plotësuar deklaratat për mungesë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 që parashikon detyrimin e institucioneve të rivlerësimit për të ushtruar funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18.3. Pretendimi se Komisioni ka vepruar në shkelje të rëndë të procedurës pasi ka zhvilluar procesin e rivlerësimit bazuar vetëm në dy kritere, atë të vlerësimit të pasurisë dhe të figurës, bie ndesh me parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016¹¹, i cili shprehimisht parashikon mundësinë e vendimmarrjes edhe sipas një kriteri, dhe nuk gjen mbështetje as në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës nuk do të kishte asnjë vlerë vazhdimi i këtij procesi për kriterin tjetër – të vlerësimit të aftësive profesionale – për sa kohë arrihet në konkluzionin se edhe në verifikim të dy kritereve, sikurse në rastin konkret, rezulton që subjekti i rivlerësimit duhet të largohet nga sistemi i drejtësisë me qëllim që besimi i publikut të kthehet dhe sistemi të mirëfunksionojë. Ky qëndrim është edhe në funksion të moszvarritjes së procesit të rivlerësimit me hetime dhe rivlerësime për kritere që edhe nëse rezultojnë me nivel minimal kualifikues, nuk ndryshojnë në tërësi rezultatin mbi procesin e rivlerësimit të subjektit, por përkundrazi e zvarritin dhe rrisin kostot e tij¹².

¹⁰ Më datë 27.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dhe bashkëlidhur 70 akte dhe dokumente shoqëruese; më datë 08.01.2019, subjekti i rivlerësimit ka dërguar përgjigjen mbi kontratat me OSHEE-në; më datë 22.01.2019, janë regjistruar përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për pyetjet shitesë të pyetësorit nr. 2; më datë 28.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën për njohjen dhe marrjen e dokumentacionit të kërkuar; më datë 06.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën e marrjes së dokumentacionit (denoncime) në formë elektronike [CD]; më datë 14.03.2019, subjekti ka përcjellë shpjegimet dhe provat në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, të përbërë nga një material me shpjegime (21 faqe) dhe 6 akte në cilësinë e provës (11 faqe), të listuara me emërtimin "Lista e inventarit që shoqëron materialin e punuar mbi gjetjet e hetimit administrativ nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Çlirim Shahini"; më datë 19.03.2019, subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore; më datë 21.03.2019, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime me gojë dhe me shkrim lidhur me çështjet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit.

¹¹ Neni 4, pika 2 parashikon: "[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]".

¹² Shih arsyetimet në vendimet e Kolegjit nr. 3/2018, nr. 4/2018, nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 11/2018, nr. 1/2019, nr. 2/2019, nr. 3/2019, nr. 8/2019, nr. 15/2019, nr. 23/2019, nr. 28/2019, nr. 29/2019, nr. 34/2019 etj.

18.4. Në konkluzionet që lidhen me vlerësimin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë, Komisioni shprehet se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës. Ky vlerësim rezulton të jetë pasojë e interpretimit të provave në raport me rrethanat faktike dhe jo e mosadministrimit të provave nga Komisioni.

19. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për kërkesat e subjektit të rivlerësimit lidhur me marrjen e provave që janë kërkuar pas kalimit të barrës së provës, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, neneve 49, pika 9 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 183 të K.Pr.Civile duke dhënë një vendim tërësisht të padrejtë, të pabazuar, të njëanshëm dhe në kundërshtim me provat dhe faktet e paraqitura.* Subjekti i rivlerësimit argumenton se Komisioni ka detyrimin ligjor që, në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, të disponojë me vendim të ndërmjetëm, në mënyrë që palët të mbahen të informuara dhe të ndërgjegjshme për cilësinë e mbrojtjes së tyre, t'u respektohet e drejta e mbrojtjes dhe të garantohen standardet e procesit të rregullt ligjor.

19.1. Në vijim edhe të arsyetimit në paragrafin e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj. Barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni, sipas nenit Ç, pika 5 e Aneksit, të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, bie mbi subjektin e rivlerësimit. Ligji nuk parashikon detyrimin e Komisionit të shprehet me vendim të ndërmjetëm për çdo akt dhe dokument të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të mbrojtjes në këtë proces. Paraqitja e dokumenteve dhe akteve që subjekti vlerëson se mbështesin dhe plotësojnë mbrojtjen e tij është në vlerësimin e vetë subjektit, ndërsa detyrimi i Komisionit, referuar nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është t'i bëjë me dije atij se për cilat çështje provat kanë nivelin e provueshmërisë. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se në vijim të sa më sipër, është detyrë e subjektit të rivlerësimit të vlerësojë mënyrën se si ai do të realizojë mbrojtjen e tij për të provuar të kundërtën për gjetjen/gjetjet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ.

19.2. Nga dokumentacioni në fashikull rezulton se shpjegimet dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, janë administruar nga Komisioni, dhe se asnjë prej këtyre akteve nuk është refuzuar. Po ashtu, nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore të jenë parashtruar kërkesa apo debatuar çështje që lidhen me administrimin e provave që subjekti ka paraqitur në Komision. Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit lidhen kryesisht me kërkesa për hetim të thelluar (specifikisht për dosjen e Shërbimit Informativ Shtetëror, ShISh) dhe për vijimin e procesit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

20. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se sjellja e trupës gjyquese të Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, pasi është e njëjta trupë që edhe heton edhe gjykon faktet. Po ashtu, ai parashtron se në procedurën e ndjekur ka elemente të theksuara të paragjyqimit, të një vendimi të paracaktuar, në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.* Subjekti i rivlerësimit argumenton se çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit nga e njëjta trupë gjyquese cenon parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe për këtë i referohet jurisprudencës së GjEDNj-së, duke cituar pjesë nga vendimi që i përket çështjes *Belilos kundër Zvicrës*. Sipas subjektit, duke qenë se nenet 6 dhe 8 të KEDNj-së janë të detyruara për zbatim edhe nga Komisioni, kufizimet e të drejtave të subjekteve nuk mund të tejkalojnë kufizimet e vendosura nga KEDNj-ja dhe duhet të jenë në përputhje me garancitë

kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, të cilat nuk mund të zhbëhen nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.

20.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky argument i subjektit bie ndesh me normat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë funksionimin e Komisionit dhe Kolegjit. Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e një sërë parimeve themelore kushtetuese, përfshirë barazinë përpara ligjit, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe parime të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Përkundër dhe përpos kompetencës që Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar për Komisionin, në funksion të garantimit në praktikë të zgjidhjes ligjore, ligjvënësi ka përcaktuar Kolegjin si e vetmja gjykatë e procesit që ka tagrat të kontrollojë dhe korrigjojë gjithë gabimet procedurale të konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision.

20.2. Në këtë kontekst, Kolegji sjell në vëmendje së pari që procesi i rivlerësimit është administrativ dhe kryhet mbi parimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016. Kur është rasti, mund të zbatohen edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative. Konceptet e referuara nga subjekti mbi prezumimin e pafajësisë janë të pavenda nga ana teknike në këtë proces. Gjithsesi, edhe parimet e zhvilluara nga jurisprudenca e GjEDNj-së që ka sjellë në vëmendje subjekti i rivlerësimit, në rastin e Belilos, pavarësisht se në kontekstin e një procesi penal e për rrjedhojë përtej fushës së veprimit të një procesi me natyrë tejet administrative si rivlerësimi – janë garantuar në këtë proces nëpërmjet ekzistencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Konkretisht, në rastin e Belilos¹³, GjEDNj-ja theksoi rëndësinë që ka rishikimi nga një gjykatë i çështjeve për shkaqe të faktit dhe ligjit, si garanci e respektimit të procesit të rregullt. Në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm për nga ana e shkaqeve me natyrë procedurale dhe themelore nga ana e Kolegjit, trupi gjykues vëren se garancitë e shtjelluara edhe në këtë çështje të sjellë në vëmendje nga subjekti në mbështetje të ankimit të tij, janë siguruar nëpërmjet Kolegjit.

20.3. Së dyti, kufizimi i justifikuar i të drejtave të subjekteve të rivlerësimit në këndvështrim të nenit 8 të KEDNj-së, është analizuar gjerësisht nga Amicus Curiae e Komisionit të Venecias, si dhe nga Gjykata Kushtetuese. Në Amicus Curiae të Komisionit të Venecias, është konstatuar se sa u përket dispozitave që rregullojnë kriterin e kontrollit të figurës në raport me nenin 8 të KEDNj-së:

“[...] kontrolli i figurës ka për synim të verifikojë deklaratat [...] për të përcaktuar nëse [gjyqtarët dhe prokurorët] kishin kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Si rrjedhojë, ky është një qëllim legjitim në dritën e paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së (interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, parandalimin e çrregullimit ose krimin, ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve). Për Komisionin e Venecias, ka rëndësi që grupi i punës [...] që përbëhet kryesisht nga personel i sigurisë, të funksionojë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e institucioneve të rivlerësimit dhe që materiali që i vihet në dispozicion grupit të punës, t’u vihet në dispozicion edhe atyre. Komisioni i Venecias është i mendimit që ndërsa kontrolli i figurës padyshim ndërhyr në jetën private, nuk mund të konsiderohet domosdoshmërisht si një ndërhyrje e pajustificuar me jetën private dhe familjare të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kundërshtim me nenin 8 të KEDNj-së [...]”¹⁴.

Ndërsa pas analizës së të njëjtës çështje, parë në këndvështrim të kufizimeve të ligjshme, nisur edhe nga opinioni i mësipërm, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se:

¹³ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22%3A%22001-57434%22%7D>

¹⁴ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e), paragrafi 64.

“[...] ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë. Gjykata rithekson se është detyrë e organeve të reja kushtetuese të rivlerësimit që gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së organeve ligjzbatuese të kërkojnë respektimin e standardeve evropiane dhe jurisprudencën e kësaj gjykate [...]”¹⁵.

20.4. Nga shqyrtimi i akteve të administruara dhe nga leximi tërësor i vendimit, nuk evidentohen të dhëna, qoftë edhe në formën e indicieve të relatuara nga vetë subjekti, se vendimi i Komisionit ka qenë i paracaktuar apo i paragjykuar. Ky pretendim mbetet i pakuptimtë në kushtet kur nuk provohen motivet për një vendimmarrje të paracaktuar apo të paragjykuar.

- 21.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka dalë nga misioni kushtetues dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenet 1 e 2 të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur standarde të dyfishta në raste të ngjashme, duke e vendosur atë në pozita diskriminuese. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit pasqyron në ankim pjesë nga arsyetimi i vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit*¹⁶.

21.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit përforcon arsyetimin e mësipërm mbi kujdesin e legjislatorit për të parashikuar juridiksionin gjyqësor të vetë Kolegjit (shih paragrafin 20.1 dhe 20.2, më sipër). Vendimi tek i cili referohet subjekti në mbështetje të pretendimit të tij, i është nënshtruar kontrollit të Kolegjit dhe është ndryshuar. Tashmë në jurisprudencën e Kolegjit është konsoliduar qëndrimi se saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë elemente përcaktuese për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë¹⁷. Nga ana tjetër, ky pretendim vlerësohet i pabazuar në prova në kushtet kur subjekti nuk provon arsyet që sipas tij kanë qenë shkas i diskriminimit dhe as veprimet e Komisionit që kanë përbërë diskriminim kundrejt atij vetë. Për më tepër, vetë subjekti nuk parashtron të ketë poseduar asnjë prej cilësive të mbrojtura nga neni 18 i Kushtetutës¹⁸, përfshirë gjininë, racën, fenë, përkatësinë etnike etj.

- 22.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se interpretimi dhe vlerësimi i konstatimeve nga ana e Komisionit është përtej synimeve dhe qëllimeve të kuadrit ligjor dhe frymës së procesit të reformës në drejtësi. Qëllimi i legjislatorit është të evidentojë gjyqtarët dhe prokurorët që kanë në pronësi pasuri që nuk mund t'i justifikojnë ligjërisht ose që nuk kanë deklaruar saktësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur me ta, të cilat çojnë në dyshimin e krijimit të tyre nga veprime korruptive, abuzime me detyrën dhe veprimtari të kundërligjshme. Meqenëse ky pretendim i subjektit lidhet me rezultatet e vlerësimit të kriterëve, analiza për*

¹⁵ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php, vendimi 2/2017, paragrafi 64.

¹⁶ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/09/Vendim-Xhezair-Zaganjori.pdf>

¹⁷ Shih qëndrimin e shprehur në vendimin nr. 19/2019 - http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf

¹⁸ Neni 18 i Kushtetutës parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

këtë shkak do të ezaurohet nga shqyrtimi që Kolegji u ka bërë shkaqeve të ankimit lidhur me këto kritere si më poshtë.

23. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor në kuptim të neneve 4, pika 5 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit, ka treguar një nxitim të pashpjegueshëm, duke caktuar brenda javës seancën dëgjimore dhe ka konsideruar përfundimtare rezultatet e hetimit administrativ të datës 27.02.2019, pa marrë aspak në shqyrtim provat dhe shpjegimet e paraqitura prej tij më datë 14.03.2019.* Subjekti i rivlerësimit i referohet rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi gjyqtarët, të miratuar më 17.11.2010 CM/Rec. (2010/12), dhe parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 për të argumentuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe citon pjesë nga vendimi i Komisionit, për të ilustruar që subjekti paraqiti shpjegime dhe prova në përgjigje të barrës së provës më datë 14.03.2019 dhe u njoftua për seancën dëgjimore të datës 21.03.2019, dy ditë më herët, në datë 19.03.2019.

23.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi sipas ligjit nr. 84/2016, parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit në shqyrtimin e çështjes synojnë që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Sipas vendimit, për shkak të problematikave të evidentuara dhe të trajtuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës, dhe të fakteve të verifikuara bazuar në denoncimin e publikut, Komisioni ka disponuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Me fjalë të tjera, vendimi për shkarkimin e subjektit është bazuar në hetimin e dy kritereve të procesit të rivlerësimit dhe të dhënave nga një denoncim nga i cili Komisionit i ka rezultuar mangësi profesionale, të cilat kanë afektuar edhe besimin te publiku. Në këto kushte, masa e shkarkimit për subjektin nuk mund të argumentohet se ishte disproporcionale. Ky interpretim, i bazuar edhe në balancën e vendosur nga Kushtetuta dhe ligji në funksion të procesit të rivlerësimit, është në përputhje me proporcionalitetin e masës disiplinore, parashikuar ndër të tjera edhe nga Rekomandimi CM/Rec.(2010)12¹⁹. Përpos faktit që qëllimi i procesit të rivlerësimit është shumë më i gjerë pasi lidhet me pavarësinë e sistemit gjyqësor, me funksionimin e shtetit të së drejtës dhe kthimin e besimit të publikut te drejtësia, parimi i proporcionalitetit është një nga parimet bazë të punës së institucioneve të rivlerësimit në garantimin e të drejtave të subjekteve, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

23.2. Lidhur me pretendimin e “ngutjes” nga Komisioni, sipas parashkrimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, pa dashur të përsërisë analizën e kohëzgjatjes së hetimit administrativ shtjelluar më sipër në paragrafin 18.1, çmon se caktimi i datës së seancës dëgjimore, sidomos nën dritën e faktit që hetimi për subjektin e rivlerësimit rezultoi të ketë zgjatur një vit – nga datat 22.03.2018 deri në datë 21.03.2019 – është në varësi të disponibilitetit të Komisionit në koordinim me vetë subjektin. Duke pasur parasysh këtë kohëzgjatje 12-mujore të hetimit, periudha kohore midis datës 15.03.2019 – datës së regjistrimit në Komision të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti – dhe ftesës më datë 19.03.2019 për seancën dëgjimore më datë 21.03.2019, që përbën vetëm hapat fundorë të ndjekur nga Komisioni për të vendosur për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, rezultoi të jetë distancë kohore e mjaftueshme dhe arsyeshme për t’i dhënë mundësi subjektit të marrë pjesë në seancë dhe Komisionit për të analizuar shpjegimet dhe aktet e sjella në përgjigje. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar se Komisioni ka ndjekur një procedurë të paligjshme, për shkak të kohës së veprimeve të ndjekura, nuk është bindës.

¹⁹ <https://rm.coe.int/cmrec-2010-12-on-independence-efficiency-responsibilities-of-judges/16809f007d>

24. *Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave duke e kthyer seancën dëgjimore në formale, duke e ftuar në seancë dëgjimore në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59 dhe 87, pika 2, shkronja “ç” e K.Pr.Administrative dhe me pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë të unifikuar – për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, pasi duhej të njoftohej për rezultatin përfundimtar të hetimit. Subjekti i rivlerësimit argumenton se Komisioni ka zbatuar keq ligjin nr. 84/2016 për përdorshmërinë e provave të paraqitura prej tij, pasi nuk ka vlerësuar pretendimet e tij para dhe pas seancës dëgjimore, duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet e tij në lidhje me konstatimet e Komisionit, në zbatim të parimit të kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve.*

24.1. Nga aktet në fashikull, konstatohet se më datë 19.03.2019²⁰ është zhvilluar mbledhja e trupit gjykues të Komisionit, ku janë relatuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit më datë 15.03.2019²¹ për rezultatet e hetimit dhe është caktuar seanca dëgjimore më datë 21.03.2019. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se trupa gjykuese e Komisionit është mbledhur pasi subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar provat dhe shpjegimet me shkrim, ka dëgjuar relatorin e çështjes dhe, në përfundim, ka vendosur të kalojë çështjen në seancë publike dhe të njoftojë subjektin për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës. Seanca dëgjimore me subjektin është zhvilluar brenda afatit 15-ditor nga data e njoftimit të subjektit për t’u dëgjuar. Të gjithë këta hapa rezultojnë të jenë në përputhje me procedurën e parashikuar në pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë të unifikuar”²².

24.2. Po ashtu, Komisioni ka respektuar kërkesat formale të legjislacionit, përfshirë edhe ato të cituara nga subjekti, pasi ka administruar provat e paraqitura prej tij, e ka njohur me rezultatet e hetimit administrativ, me të drejtat e tij në këtë fazë të procesit, si dhe i ka dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të dëgjohet dhe të mbrohet gjatë seancës dëgjimore. Në seancën dëgjimore relatorja ka theksuar se: *[...] Në përgjigje të barrës së provës për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit solli prova dhe shpjegime të cilat trupi gjykues do të shprehet së bashku me vendimin përfundimtar [...].* Nuk rezulton që vetë subjekti të ketë kundërshtuar këtë qëndrim të relatores apo të ketë shprehur kërkesa e pretendime lidhur me kohën në dispozicion për njoftimin, apo mbi shkeljet e të drejtave të tij gjatë seancës dëgjimore, sikurse pretendon në ankim. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni në gjykimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit ka respektuar parimin e kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve.

25. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit për shkelje të parimeve procedurale dhe cenim të procesit të rregullt ligjor nuk qëndrojnë. Ky konkluzion është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi zbatimin e parimeve të gjykimit kontradiktor, që i jep rëndësi të veçantë në proces krijimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësisë së deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me

²⁰ Sipas procesverbalit nr. 3, datë 19.03.2019.

²¹ Regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 15.03.2019.

²² <http://kpk.al/wp-content/uploads/2017/11/Hapat-Procedurele-te-Unifikuar.pdf>. Pika 10 parashikon: “Kur dosja është gati, pasi ka përfunduar edhe afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti, relatori përgatit relacionin përfundimtar dhe ia vë në dispozicion trupës dhe vëzhguesit ndërkombëtar”. Po aty, pika 11 parashikon: “Trupa, në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, mund të vendosë për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Në këtë rast trupa vendos për njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t’u dëgjuar në seancë”.

çështjen që shqyrtohet në gjykatë²³. Po ashtu, siç është shtjelluar edhe më sipër, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave dhe vazhdimin e hetimit administrativ për kriterin e tretë – vlerësimi i aftësive profesionale – konsiderohet e panevojshme pasi nuk ndikon në rezultatin në tërësi të procesit të rivlerësimit të subjektit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriteret e vlerësimit²⁴

I. Arsyetimi i Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

26. Lidhur me vlerësimin që Komisioni ka kryer për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit fillimisht parashtron shkaqe që lidhen me zbatimin e gabuar të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30, 32, 33 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nga ana e Komisionit. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së; është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me subjektet e tjera lidhur me “pasaktësinë në deklaram”, duke cenuar parimin e sigurisë juridike; nuk konstatohen pasaktësi në deklaratën *vetting*, ndërsa pasaktësitë në deklaramet periodike nuk cenojnë apo venë në diskutim të provuarin bindshëm të burimit të krijimit të ligjshëm të pasurive të deklaruara dhe jo çdo pasaktësi përbën shkak për shkarkimin nga detyra; ka treguar subjektivizëm në vlerësimin e provave, nuk vërtetohet ekzistenca e ndonjë prej rasteve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe shkarkimi bazuar në nenin 61, pika 3 e këtij ligji kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të dy kriterëve – pasuria dhe figura, ndërkohë që në rastin e tij nuk ekziston kushti i dytë, ai i pamjaftueshmërisë së figurës; sjellja e tij nuk është në të njëjtin nivel kundërligjshmërie si ato të parashikuara në nenin 61, pikat 1, 2, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016; nuk ka kryer shkelje të rëndë në raport me deklaramin e pasurisë pasi ka deklaruar me vërtetësi shumat e të ardhurave dhe pasuritë e siguruar ndërsa vite nga burime të ligjshme; nuk ka kryer fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë dhe, për rrjedhojë, nuk ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm.

26.1. Në krye të analizës për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se rëndësia e hetimit të pavarur nga institucionet e rivlerësimit mbi bazën e raporteve të institucioneve të pavarura si ILDKPKI-ja dhe DSIK-ja, është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, mbështetur në Opinionin e Komisionit të Venecias, ku është theksuar se:

[...] Kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të. Për më tepër, kjo është e rëndësishme për të evituar çdo ndërhyrje të mundshme nga organet në varësi të pushtetit ekzekutiv, veçanërisht në rastin e kontrollit të figurës, shqetësim ky i ngritur edhe në opinionin e Komisionit të Venecias. Vetëm duke garantuar që organet e rivlerësimit do të kenë kontrollin e plotë të këtij procesi dhe, nëse është e nevojshme, mundësinë të

²³ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 16.04.2015, nr. 34, datë 29.05.2015 dhe nr. 37, datë 30.06.2016.

²⁴ Trupi gjykues i Kolegjit zgjedhi të trajtojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit sipas renditjes që ndjek ligji nr. 84/2016, e konkretisht duke filluar me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës, e duke e përmbysur analizën me shkaqet që lidhen me cenimin e besimit të publikut. Kjo zgjedhje nuk ndikon në asnjë rrethanë sa u përket gjetjeve që lidhen me formën dhe përmbajtjen e vendimit të Komisionit.

*përcaktojnë edhe modalitete të tjera të bashkëpunimit me organet ekzistuese, rast pas rasti, gjykata vlerëson se do të garantohet respektimi i parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe do të parandalohet ushtrimi i kompetencave ligjore në mënyrë të pakontrolluar nga ana e organeve ekzistuese*²⁵.

Në zbatim të këtyre parimeve dhe të dispozitave ligjore²⁶, institucionet e rivlerësimit kryejnë hetimet e tyre bazuar në burime të ndryshme të dhënash dhe, për pasojë, edhe konkluzionet pasqyrojnë vlerësimin e tërësisë së informacionit të administruar dhe analizuar për këtë efekt në secilën shkallë. Për këto arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i papabuar në ligj.

26.2. Lidhur me vlerën e pasaktësive në deklarime, tashmë Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar mbi mënyrën se si ato interpretohen në analizën e përgjithshme të kriterit të vlerësimit të pasurisë²⁷. Megjithatë, sikurse konstatohet dhe nga trajtimi që i ka bërë Komisioni këtij kriteri, vlerësimi negativ dhe aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit mbi bazën e kontrollit të pasurisë, nuk rezultojnë të jetë derivat i vetëm pasaktësive në deklarime, sikurse e paraqet subjekti i rivlerësimit. Përkundrazi, konkluzioni i kontrollit të pasurisë si shkak për masën disiplinore, rezultojnë të jetë derivat i konstatimit të deklaramit të rremë, mosshpjegimit bindshëm të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave dhe me përpjekje për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim, në kuptim të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës²⁸. Lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me subjektet e tjera për të njëjtat shkelje që lidhen me deklaramin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkak të pasaktësive në deklarime, duke referuar pjesë nga arsyetimi i vendimit të Komisionit nr. 51,

²⁵ Paragrafi 44 i vendimit nr. 2/2017 në: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php. & paragrafi 62 i Opinioneve të Komisionit të Venecias: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

²⁶ Neni 45 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. 2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të këtij ligji. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit”.

²⁷ <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/12/Vendimi-i-Anonimizuar-subjekti-T.-Ndreca.pdf>.

²⁸ Për pasurinë e paluajtshme në Sarandë, Komisioni arriti në përfundimin se:

a) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të rremë në deklaratën “vetting” edhe gjatë hetimit administrativ në lidhje me apartamentet në pronësi të tij; shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

b) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të rremë në deklaratën “vetting” dhe gjatë hetimit administrativ, si dhe në deklaratat e interesave private të viteve 2011 - 2013, në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj banese, ka ndërmarrë veprime fiktive, me qëllim fshehjen e ndërtimit të kësaj banese gjatë viteve 2011 – 2013, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

c) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “vetting” nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shoqërisë “{***}” ShPK, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

ç) subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të dhëna hua nga z. D. P., bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

datë 25.07.2018²⁹, Kolegji thekson se vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit prej tij, çka adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës³⁰.

26.3. Lidhur me kuptimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për zbatimin në mënyrë jo kumulative të pamjaftueshmërisë së dy kritereve atë të pasurisë dhe të figurës, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pamjaftueshmëria e vlerësimit të pasurisë është një situatë e ndryshme dhe e veçantë nga situata e pamjaftueshmërisë së kontrollit të figurës. Ndërsa e para zberthen përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pamjaftueshmëria e figurës zberthen përcaktimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës. Në kushtet kur parashikimet e nenit D dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës qëndrojnë të pavarura nga njëra-tjetra, nuk konsiderohen me natyrë kumulative – pa njërin nuk ekziston tjetra – dhe zberthimi i këtyre parashikimeve kushtetuese ka gjetur pasqyrim në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ku pamjaftueshmëria në deklarimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe pamjaftueshmëria në deklarimin e kriterit të kontrollit të figurës janë raste të veçanta, të pavarura nga njëra-tjetra dhe me natyrë jokumulative. Këto dy përcaktime të veçuara kanë të njëjtën peshë sikurse shkeljet e parashikuara nga pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, në konkluzionet përfundimtare, Komisioni ka konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime për të dyja kriteret – të pasurisë dhe të figurës – për rrjedhojë aplikimi nga Komisioni i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është i drejtë.

27. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme objekt dy kate + papafingo, me sip. 387 m², ndërtuar mbi objektin me {***} kate, pronë e z. D. R. , si person tjetër i lidhur, subjekti pretendon se burim krijimi janë të ardhurat familjare dhe kontrata e huadhënies e datës 07.01.2014. Ndërtimi është financiar nga vetë ai. Analiza financiare mbi burimin e të ardhurave të z. D. R. për ndërtimin e godinës {***}-katëshe në vitin 2001 nuk është e saktë dhe se ai [D. R.] nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme.*

27.1. Subjekti i rivlerësimit parashtrohet se z. D. R. ka qenë emigrant dhe në vitin 2001 ka ndërtuar godinën 3-katëshe, ku banon aktualisht. Subjekti i rivlerësimit ka shkuar në Sarandë në vitin 2003 dhe ka jetuar në banesën e z. R. nga viti 2003 deri në vitin 2015. Z. R. nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e godinës {***}-katëshe dhe Komisioni kishte mundësi të merrte informacion për të vërtetuar të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga toka bujqësore. Sa i përket gjendjes së ambienteve në pronësi të z. R. , të dhëna me qira si njësi akomodimi, subjekti parashtrohet se cilësia e fotove të sjella prej tij për të dokumentuar pasurinë e tij dhe të z. R. , të marra me aparatit e telefonit personal më datë 19.01.2019, në ndryshim nga ato që janë pasqyruar në internet, të cilat janë kryer me aparat fotografik profesional, nuk mund të përdoret në disfavor të tij. Subjekti deklaron se ambientet e tij përbëhen nga dy kate + papafingo. Në njërin prej kateve banon subjekti me familjen gjatë muajit gusht. Kati tjetër është dhënë me qira me kontratën e datës 01.02.2018. Kati papafingo me sipërfaqe 107 m² është i papërfunduar. Për gjendjen e katit të papafingos, subjekti ka depozituar edhe një video, e cila sipas Komisionit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës. Subjekti sqaron se në përgjigjet e pyetësorëve ka deklaruar se z. R. ka një kat në të cilin banon vetë me familjen dhe dy kate, të cilat në sezonin veror i jep për pushues. Tabela reklamuese “{***}” është vendosur në pjesën veriperëndimore, sipër hyrjes së z. R. , ndërsa subjekti ka një hyrje tjetër. Asnjë prej ambienteve të tij nuk përdoret për hoteleri dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se ka dhënë me qira një apartament, duke e shoqëruar me kontratën e qirasë dhe me vërtetimin nga organet tatimore për pagesën e tatimit nga këto të ardhura. Subjekti parashtrohet se kati i fundit i papafingos nuk është i

²⁹ <http://kpk.al/wp-content/uploads/2018/09/Vendim-Ardian-Dvorani.pdf> .

³⁰ *Shih Beian v. Romania (no. 1), §§ 37 dhe 39; Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], §§ 116-35).*

përfunduar. Në vitin 2016, kur është transferuar me punë në Lushnjë, subjekti i ka dhënë z. R. me marrëveshje verbale afërsisht gjysmën e katit, në pjesën perëndimore të të cilit janë kryer punime dhe ka jetuar nëna e tij [e z. R.]. Gjatë sezonit të verës, për vitet 2017, 2018, ai e ka shfrytëzuar si njësi akomodimi për pushues. Hyrja kryhet nga shkalla e z. R. , në pjesën perëndimore.

27.2. Nga dokumentacioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka jetuar te z. D. R. pa shpërblim, ndërsa për një periudhë dyvjeçare ka jetuar aty edhe nëna e tij [e subjektit] po ashtu pa asnjë shpërblim³¹. Ky deklarim është konfirmuar edhe nga z. D. R. nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 24.11.2018³². Po kështu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për shkak të marrëdhënieve të mira, në vitin 2011 i ka kërkuar z. R. të ndërtonte kate shtesë mbi banesën e tij³³. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision një sërë dokumentesh që provojnë pronësinë e z. R. mbi 3 katet e godinës, si dhe burimin e të ardhurave për ndërtimin e kësaj godine, të tilla si: dokumentacioni i legalizimit, certifikatat e pronësisë të apartamenteve në pronësi të z. R. ; deklaratat noteriale datë 09.12.2013, datë 19.01.2019 dhe datë 21.01.2019, sipas të cilave të ardhurat e z. R. janë siguruar nga shfrytëzimi prej vitit 1991 të tokës arë të përfituar me AMTP-në e datës 31.03.1996 dhe nga shitja e pasurisë shtëpi dhe truall në fshatin {***}, Delvinë, në vlerën 3.000.000 lekë, foto të apartamenteve në pronësi të z. D. R. , kontratën e sipërmarrjes së ndërtimit me z. R. , datë 22.03.2011. Nga shkresa e Drejtorisë Tatimore Sarandë të datës 18.01.2019³⁴, rezulton se z. D. R. ka qenë i regjistruar si tatimpagues, me objekt aktiviteti përpunime hekuri, i regjistruar në datën 30.10.2008 dhe i çregjistruar më datë 15.05.2018. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni për pasurinë e deklaruar nga subjekti në faqet e internetit, ka rezultuar se ajo përdoret si njësi akomoduese me emrin “{***}.” Sipas Komisionit, e gjithë ndërtesa, përfshirë edhe katin e fundit, promovohet si njësi akomodimi. Ndërkohë që fotot e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, sipas Komisionit, nuk janë cilësore dhe nuk përputhen me fotot e publikuara në faqet e internetit, të cilat tregojnë një godinë me dhoma të mobiluara në mënyrë moderne, funksionale dhe në gjendje shumë të mirë³⁵.

27.3. Nga sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vëren se fakti që subjekti i rivlerësimit ka qëndruar pa shpërblim përreth 12 vite (2003 – 2015) në pronën e z. R. dhe ky e ka lejuar subjektin të ndërtojë mbi banesën e tij, nuk është ndër rrethanat që mund ta kategorizojë këtë marrëdhënie si atë me një person tjetër të lidhur, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016³⁶. Për rrjedhojë, barra e provës që i ka kaluar subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. D. R. për ndërtimin e godinës, për shkak të banimit dhe ndërtimit mbi godinën ekzistuese, nuk është në frymën e kërkesave të ligjit nr. 84/2016 që parashikojnë të provuarin bindshëm të burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi, që posedojnë ose që kanë në përdorim nga personat e tjerë të lidhur. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka gabuar kur ka çmuar se mospërputhjet ndërmjet deklaratave noteriale dhe shpjegimeve të subjektit për të provuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të godinës me {***} kate nga z. R. , duhet të analizoheshin nën dritën e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe të shoqëroheshin me prezumimet për subjektin e rivlerësimit.

³¹ Pyetësori i Komisionit, datë 03.12.2018.

³² Nr. {***} prot., nr. {***} kol.

³³ Në përgjigje të pyetjes 3 të pyetësorit të Komisionit, datë 22.01.2019.

³⁴ Shkresa nr. {***} prot.

³⁵ Paragrafët 55 dhe 56 të vendimit.

³⁶ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

27.4. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave privatë vjetorë/periodikë apo në deklaratën *vetting*, si dhe në asnjë nga pyetësorët gjatë hetimit administrativ, se një pjesë e pasurisë së tij jepej me qira si njësi akomoduese, qoftë kjo edhe nga z. R. . Për herë të parë, subjekti ka shpjeguar destinacionin e të paktën një pjese të godinës si njësi hotelerie në datë 22.01.2019. Duke filluar nga pyetësi i parë, kur është pyetur për shpenzime mobilimi sipas viteve për secilin apartament, subjekti ka thënë: [...] *Apartamenti i ndodhur në Sarandë nuk ka qenë i mobiluar deri në datën që është dhënë me qira, sipas kontratës datë 01.02.2018*³⁷, *shtetasit I. J.. Kati papafingo është i pamobiluar dhe i papërfunduar*. Pyetjes së Komisionit për destinacionin e *apartamenteve* dhe nëse jepen me qira të sillte dokumentacion provues (pyetja 6), subjekti i është përgjigjur vetëm për apartamentin e dhënë me qira të z. J., duke bashkëlidhur kontratën e qirasë. Vetëm në përgjigjet e pyetësorit shtesë, më datë 22.01.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë se ambientet e z. R. [dy kate], përdoren si njësi akomoduese prej vitit 2015. Në këtë pyetësor, subjekti është pyetur specifikisht për destinacionin e ndërtesës dhe të konfirmonte nëse tri katet në pronësinë e tij janë dhënë me qira (pyetja 3). Sërish, subjekti ka përmendur kontratën e qirasë me z. I. J. dhe ka bashkëlidhur vërtetimin e pagesës së tatimit në burim. Përgjigjeve të dhëna në këtë pyetësor, subjekti u ka bashkëlidhur fotografi të apartamenteve të z. R. dhe të apartamenteve të secilit kat që ka në pronësi, të cilat nuk tregojnë qartësisht gjendjen e ambienteve të brendshme të godinës. Fotografitë dhe videoja e depozituar në Komision për katin e fundit të papafingos, tregojnë ambiente të parregulluara dhe të pamobiluara. Më tej, dhënia e një pjese të papafingos fillimisht për strehimin e nënës së z. R. dhe më pas e përdorur prej këtij të fundit në vitet 2017 dhe 2018 si njësi akomodimi për pushues gjatë sezonit veror, është deklaruar vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, më datë 14.03.2019³⁸. Po kështu, subjekti është kontradiktor edhe në ankim kur argumenton gjendjen e ambientit të papafingos, kur nga njëra anë pohon se ka në pronësi këtë ambient me sipërfaqe 107 m² që është i papërfunduar dhe se asnjë ambient i tij nuk përdoret për hoteleri dhe, nga ana tjetër, sqaron se afërsisht gjysma e ambientit të papafingos është rregulluar, mobiluar dhe shfrytëzohet për pushues sezonalë nga z. R. . Në këtë situatë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke zgjedhur të mos jetë i sinqertë në shpjegimet mbi gjendjen dhe përdorimin e pasurisë që ai disponon, përbën një rrethanë që më së pakti, në këndvështrimin e një vëzhguesi objektiv, përbën arsye që të cenohet besimi i publikut te drejtësia, në kushtet kur një magjistrat përfiton të ardhura nga turizmi i palicencuar, haptazi³⁹, në një qytet bregdetar shumë të vogël, ku individi dhe funksioni me të cilin ai shoqërohet ndërthuren në mënyrë të pandarë.

27.5. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, duke zgjedhur të mos deklaronte përdorimin e ambienteve për qëllime hotelerie, qoftë kjo edhe për një pjesë të pronës, tregon mungesë sinqeriteti dhe mirëbesimi në raport me procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, pavarësisht se disa nga argumentet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. R. janë të drejta, ato nuk zhbëjnë mungesën e saktësisë së deklaratimit nga ana e tij për përdorimin dhe, për pasojë, përfitimet që ka vjelë nga një aktivitet turistik i paautorizuar, parë edhe nga këndvështrimi i perceptimit të veprimeve të tij nga publiku në raport me detyrën.

³⁷ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

³⁸ Faqet 5 – 7 të përgjigjeve, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.03.2019.

³⁹ Pasuria reklamohet në disa nga faqet më të suksesshme turistike. Shih https://www.booking.com/hotel/al/{***}-{***}.html ose https://www.agoda.com/apartments-{***}-{***}/hotel/saranda-al.html?cid=1844104 dhe https://www.tripadvisor.com/Hotel_Review-g303165-d15849813-Reviews-Apartments_{***}_{***}-Saranda_Vlore_County.html

28. Lidhur me kohën e ndërtimit të objektit [3 dhjetor 2013 – dhjetor 2014], subjekti i rivlerësimit pretendon se deklaratimet përputhen me të vërtetën dhe kërkoi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për të administruar dhe vlerësuar provat, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve të tij se vendimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabim ose në mënyrë jo të plotë nga Komisioni.

28.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se leja e ndërtimit është miratuar në vitin 2011, por është zbardhur vetëm në vitin 2013, kur kryetar i Bashkisë tashmë ishte z. S. Ç. . Viti 2012, i pasqyruar në formularin nr. 2 të dokumentacionit, sipas subjektit është lapsus i administratës. Subjekti pretendon se nuk i ka kushtuar rëndësi zbardhjes së dokumentacionit, formularit të vendimit të KRRT-së, formularit të lejes së ndërtimit apo kopertinës së aktit të kolaudimit. Për këtë qëllim, në vitin 2019, ai i është drejtuar Bashkisë Sarandë me qëllim kontrollin e të gjithë procedurës së ndjekur. Subjekti parashtron se pavarësisht se gjetjet nga hetimi administrativ i Komisionit kanë qenë të sakta, duke pasur parasysh shkresën e Bashkisë Sarandë [datë 12.03.2019], datat që përkojnë me fillimin dhe mbarimin e punimeve kanë qenë 03.12.2013 – dhjetor 2014. Kontrata me OSHEE-në në emër të tij është lidhur më datë 03.04.2008, në datën 11.08.2015 është vendosur një aparat i ri matës, ndërsa data 31.05.2010, e vendosjes së matësit të energjisë në emër të bashkëshortes, përkon me kohën që nëna e tij ka qëndruar në garsioneren e z. R. dhe, pas ndërtimit të kateve shtesë, ky aparat është zhvendosur në katin e dhënë me qira nga subjekti. Vlerat e pasqyruara në faturat e OSHEE-së përgjatë gjithë periudhës, tregojnë konsumin familjar të tij. Subjekti parashtron se Komisioni nuk ka referuar provat e paraqitura prej tij dhe se në mënyrë të njëanshme dhe joobjektive nuk vlerëson kalimin nëpërmjet sistemit bankar të shumës 7.600.000 lekë në vitin 2014 dhe 300.000 lekë në vitin 2016, si provë për të vërtetuar kohën e ndërtimit të objektit. Sipas subjektit, leja e ndërtimit është dhënë në emër të tij, por duke qenë se kontrata me firmën ndërtuese “{***}” ShPK është lidhur në datën 03.12.2013 dhe leja e ndërtimit është zbardhur vitin 2013, pas depozitimit të kontratës në dosjen e bashkisë, leja është në emër të firmës ndërtuese.

28.2. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, që përmban të dhëna për kohën e ndërtimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se:

- a. në datën 14.01.2011, KRRT Bashkia Sarandë ka miratuar sheshin e ndërtimit, destinacionin e funksionit të tij, si dhe kondicionet urbane për objektin: banesë private shtesë dy kate + papafingo mbi 3 katet ekzistuese. Sipas protokollit të mbledhjes, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nën numrin rendor 30, pasqyrohet: *Çlirim Shahini – Pronar: D. R. – Objekti: Banesë private – Zona: Lagja nr. {***} – Kondicionet urbane: Sp = 289 m², Snd = 140 m² – Nr. i kateve ekzistues: {***} kate – Nr. i kateve shtesë: 2 (dy) + papafingo – Miratohet;*
- b. në datën 22.03.2011, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me z. D. R. , sipas së cilës ky i fundit vë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës investitore, sipërfaqen 289 m². Afati i punimeve është ai i lejes së ndërtimit – 2 vite, duke filluar 3 muaj pasi pala investitore të jetë pajisur me lejen e ndërtimit dhe vendimin e sheshit të ndërtimit;
- c. Bashkia Sarandë ka lëshuar lejen e ndërtimit në emër të subjektit ndërtues “{***}” ShPK, me financues subjektin e rivlerësimit, me afat kohor deri më datë 31.12.2014. Ky dokument nuk ka datë, por në të pasqyrohet viti 2012;
- ç. në datën 03.12.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë nënshkruar kontratën e ndërtimit për “Godinë banimi dhe shërbimi me papafingo”, me vlerë 10.520.324 lekë, me afat 365 ditë.
- d. në akt-kolaudimin e ndërtimit të objektit, cilësuar si “Banesë private, shtesë katesh {***} kate + papafingo mbi {***} kate ekzistues”, përcaktohet se fillimi i punimeve është janar 2011 dhe mbarimi i punimeve është dhjetor 2013. Akt-kolaudimi është nënshkruar nga

- ing. Dh. L. (kolaudator), nga mbikëqyrësi i punimeve, ing. K. K. , dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit (investitor). Më datë 12.03.2019, kërkesës së subjektit të rivlerësimit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Sarandë, i përgjigjet se ka *vërejtur një pasaktësi* në aktin e kolaudimit dhe në kontratën e sipërmarrjes mes investitorit dhe shoqërisë së ndërtimit, për sa u përket datave të fillimit dhe të mbarimit të punimeve dhe se po atë ditë nga kolaudatori, z. Dh. L., është paraqitur një deklaratë noteriale. Deklaruesi thotë se në aktin e kolaudimit gabimisht është pasqyruar janar 2011 - dhjetor 2013 dhe që punimet kanë filluar në fund të periudhës së dokumentuar më parë [03.12.2013], dhe përfunduar më dhjetor 2014, njëkohësisht referuar edhe kontratës me firmën ndërtuese “{***}” shpk;
- dh. subjekti i rivlerësimit ka paraqitur fatura tatimore të shitjes dhe situacione punimesh me zbatues “{***}” ShPK dhe investitor atë vetë, që i përkasin periudhës janar – prill 2014, si dhe veprime bankare/kalime pagesash nga subjekti i rivlerësimit te llogaria e “{***}” nëpërmjet Raiffeisen Bank gjatë vitit 2014, kryesisht me emërtimin “investime” ose “likuidim detyrimi”;
- e. më datë 25.10.2018, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. M. M., i është përgjigjur Komisionit⁴⁰, duke shpjeguar marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit për ndërtimin e kryer, si dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin e administruar. Sipas përgjigjeve të dhëna nga z. M., ndër të tjera, deklarohet se objekti ka përfunduar në dhjetor 2014 dhe është deklaruar i përfunduar me faturë tatimore;
- ë. sipas shkresës së OSHEE-së, datë 25.10.2018, subjekti dhe bashkëshortja kanë kontrata përdoruesi në qytetin e Sarandës duke filluar nga 03.04.2008, datë vendosje 11.08.2015, dhe 31.05.2010.

28.3. Për sa u përket deklarimeve të interesave ndër vite nga subjekti i rivlerësimit, për vitet kur ka ndodhur ndërtimi i pronës në fjalë – 2011 - 2013 – konstatohet se subjekti i rivlerësimit:

- në deklaratën për vitin 2011, nuk ka deklaruar *asnjë* nga veprimet që kanë ndodhur në lidhje me krijimin e kësaj pasurie e konkretisht, kontrata e sipërmarrjes me z. D. R. , veprimet që lidhen me kërkesën dhe miratimin e sheshit të ndërtimit nga KRRT-ja në mbledhjen e datës 14.01.2011, dhe as vendimin e kësaj të fundit të po kësaj date;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, po ashtu nuk ka deklaruar asnjë veprim/zhvillim në lidhje me këtë pasuri gjatë vitit raportues. Ndërkohë, ky vit rezulton i pasqyruar në lejen e ndërtimit me subjektin ndërtues “{***}” ShPK dhe me financues atë vetë, nga Bashkia Sarandë;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, nuk ka deklaruar asnjë nga zhvillimet që lidhen me këtë pasuri të ndodhura atë vit, e konkretisht, kontratën e ndërtimit me shoqërinë e ndërtimit “{***}” ShPK, që mban datën 03.12.2013 dhe as fillimin e punimeve për ndërtimin e pasurisë në dhjetor 2013 – sipas pretendimeve të tij të mëvonshme – apo akt-kolaudimin sipas të cilit prona ishte ndërtuar deri në dhjetor 2013.

28.4. Veprimet e mësipërme janë deklaruar për herë në parë në deklaratën *vetting*, të dorëzuar më datë 28.01.2017. Në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, subjekti ka deklaruar tri certifikata për vërtetim pronësie, dy për banesë me sipërfaqe 140 m² dhe një për banesë me sipërfaqe 107 m². Në këto tri certifikata pasqyrohet objekti dy kate + papafingo, ndërtuar mbi objektin ekzistues trekatësh në emër të D. R. , formalizuar nëpërmjet një kontrate sipërmarrjeje me nr. {***}, datë 22.03.2011. Më tej subjekti deklaroi se ka bashkëlidhur vendimin e KRRT-së, lejen e ndërtimit dhe planimetrinë e objektit lëshuar nga Bashkia Sarandë. Sipas subjektit, punimet në objekt janë kryer gjatë periudhës 2013 - 2014 me

⁴⁰ Regjistruar me nr. {***} prot., datë 29.10.2018.

kontratë marrëveshjeje, datë 03.12.2013, me firmën zbatuese “{***}” ShPK dhe ka bashkëlidhur kontrata dhe situacionet e punimeve të kryera.

28.5. Nga ana tjetër, në deklaratat e interesave privatë për vitet 2014 dhe 2015, subjekti ka deklaruar se ishte në proces ndërtimi i banesës me dy kate + papafingo dhe që ka shlyer edhe detyrimet ndaj firmës ndërtuese. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, deklaroi detyrimin ndaj z. D. P.: “[...] Qëllimi i huamarrjes është përfundimi i ndërtimit të objektit, pasi nga ana e Bashkisë Sarandë mund të kishte penalitete, duke respektuar afatin e lejes së ndërtimit [...]”. Këtë deklaramin subjekti i rivlerësimit e ka përmendur edhe në deklaratën *vetting*.

28.6. Për sa më lart, nga dokumentacioni vërehet se vendimi që miratonte sheshin e ndërtimit dhe destinacionin (në detaj në nënparagrafin 28.2.a) është lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit, kurse leja e ndërtimit [e vitit 2012, shih 28.2.c] që financohet nga subjekti i rivlerësimit, është lëshuar në emër të shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, dhe pasqyron si afat të fundit të vlefshmërisë së saj datën 31.12.2014. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se leja është lëshuar në emër të tij, por është pasqyruar në emër të shoqërisë pasi është zbardhur më vonë, nuk gjen mbështetje në këto dokumente. Sipas akt-kolaudimit të ndërtimit, nënshkruar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit (nënparagrafi 28.2.d), fillimi i punimeve për këtë objekt ka qenë në vitin 2011 dhe mbarimi i punimeve në dhjetor të vitit 2013.

28.7. Deklarata noteriale e kolaudatorit Dh. L., e kryer gjatë procesit të rivlerësimit [më datë 12.03.2019], bashkëlidhur shkresës së Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Sarandë, nuk ka vlerë provuese pasi kërkohet të vërtetohet një datë që i përshtatet versionit të fakteve në favor të subjektit, pa u mbështetur në dokumente apo fakte, të cilat shërbejnë si arsye për këtë ndryshim kronologjic. Për më tepër, ndërsa shkresa referon se *vërehet një pasaktësi* në aktin e kolaudimit dhe në aktin e sipërmarrjes mes investitorit dhe shoqërisë së ndërtimit, institucioni vetë nuk konfirmon pretendimin e subjektit se ndërtimi ka ndodhur të paktën një vit pas skadencës së afatit të përcaktuar në akt-kolaudim apo që leja është zbardhur në vitin 2013, në emër të tij. Po kështu, edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbardhje të lejes në vitin 2013 [dy vjet pas aplikimit], meqenëse dokumentet u nënshkruan nga kryetari i ri i Bashkisë, S. Ç., ndërsa kërkesa ishte trajtuar nga ish-kryetari i Bashkisë, E. Gj., nuk vërteton kohën e ndërtimit dhe as pretendimin e subjektit. Z. Ç. është zgjedhur kryetar i Bashkisë Sarandë në zgjedhjet vendore të vitit 2011⁴¹. Kjo nënkupton që teorikisht, leja e ndërtimit mund të ishte nënshkruar prej tij në çdo kohë, nisur nga shtatori 2011 e deri në mesvitin 2015. Si rrjedhojë, argumenti i subjektit që leja është nënshkruar vetëm në vitin 2013 është deklarativ, data e vendosur prej tij është arbitrare dhe, për pasojë, nuk mund të vërtetohet kohën e kryerjes së ndërtimit të objektit.

28.8. Më tej, edhe deklaratimet individuale të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK dhe faturat apo situacionet që i përkasin periudhës janar – prill 2014, apo edhe pagesat nëpërmjet bankës të shumës prej 7.600.000 lekësh në vitin 2014, nuk provojnë se koha e kryerjes së punimeve është ajo e pagesave, dhjetor 2013 dhe në vitin 2014, përkundër dokumentacionit bazë⁴², i cili për ndërtimin e kryer i referohet periudhës 2011 – 2013. Që datat e

⁴¹ Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve vendore të datës 08.05.2011 është shpallur me vendimin e KQZ-së më datë 15.09.2011 – shih <http://cec.org.al/vendimet-2011/>

⁴² Protokollin e mbledhjes së KRRT-së, kontrata e sipërmarrjes, dhe aktin e kolaudimit të nënshkruar nga dy individë në cilësi profesionale dhe vetë subjekti si pronar. Shtjelluar në detaj në nënparagrafin 28.2.a, 28.2.b dhe 28.2.d.

transaksioneve nuk vërtetojnë periudhën e ndërtimit, provohet edhe nga fakti që subjekti ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë se i ka shlyer detyrimet financiare firmës së ndërtimit edhe pas vitit 2014, përkatësisht në vitet 2015 dhe 2016. Vendimi nr. {***}, datë 14.01.2011, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicionet urbane të tij”, ka miratuar sheshin e ndërtimit, destinacionin e funksionit të tij, si dhe kondicionet urbane në emër të subjektit të rivlerësimit, por jo leje ndërtimi. Kjo e fundit rezultoi e lëshuar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, me investitor subjektin dhe pasqyrohet vitin 2012. Pretendimi i subjektit se leja e ndërtimit është lëshuar në emër të tij jo vetëm që nuk gjen mbështetje në dokumentacion, por edhe ndikimi i këtij argumenti në vërtetimin e kohës së ndërtimit rezultoi pa asnjë peshë. Si rrjedhojë, këto pretendime të subjektit u gjetën të pambështetura në fakte dhe dokumentacion.

28.9. Po kështu, edhe sqarimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata për furnizimin e energjisë elektrike në emër të bashkëshortes në vitin 2010, përkon me periudhën që nëna e tij banonte në garsioneren e z. R. , është konfuz pasi, megjithëse ambienti është në pronësi të z. R. , matësi u vendos – pa arsye apo shpjegim të kuptueshëm – në emër të bashkëshortes së subjektit. Megjithatë, nga shqyrtimi i vendimit nuk rezultoi që Komisioni të jetë shprehur apo të ketë mbajtur qëndrim lidhur me këtë paqartësi, si edhe më sipër, këto argumente nuk provojnë që koha e ndërtimit është pas dhjetorit 2013 apo gjatë vitit 2014. Për pasojë, trupi gjyqësor i konsideron kontratat me OSHEE pa vlerë provuese.

- 29.** Kërkesa e subjektit për të gjykuar çështjen në seancë publike me qëllim rivlerësimin e provave, është trajtuar gjerësisht në paragrafët që lidhen me pretendimet mbi shkeljet procedurale. Pa dashur të përsëriten argumentet e shtjelluara në pjesën B, paragrafët 18-25 më sipër, trupi gjyqësor i Kolegjit thekson se nga shqyrtimi i çështjes dhe pretendimeve të subjektit në ankim, konstaton se Komisioni ka kryer një vlerësim të drejtë dhe të plotë të provave të administruara. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të vërtetojë se ndërtimi i pasurisë së tij është kryer përgjatë periudhës 03.12.2013 – dhjetor 2014, dhe të zhbëjë dokumentacionin. Në këtë përfundim, trupi gjyqësor i Kolegjit mban në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të rremë, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë për vitet 2011, 2012 dhe 2013, kohën dhe veprimet e ndërmarra për ndërtimin e kësaj prone në raport me subjektin ndërtues “{***}”, si dhe natyrën e marrëdhënies pasurore të tij me z. D. R. .
- 30.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se huaja në vlerën 2.720.324 lekë ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, i është shlyer në vitet 2015 dhe 2016 z. M. M., në kapacitet privat, jo si subjekt ndërtues; kjo është një marrëdhënie detyrimi mes palëve e dokumentuar ndër vite. Shumat e shlyerjes së detyrimit janë deklaruar rregullisht dhe nuk ka qenë qëllim fshehja e pasurisë apo e burimit të krijimit të saj.*

30.1. Subjekti parashton në ankim se në vitin 2014, derdhjet janë kryer nëpërmjet bankës në emër të subjektit ndërtues, ndërsa për detyrimin e mbetur kanë rënë dakord me marrëveshje që ta shlyejë sipas mundësive në *cash*, duke qenë se firma kishte deklaruar në fund të vitit 2014, në tatime, objektin të përfunduar në vlerën 10.520.324 lekë. Sipas tij, referuar deklarimeve periodike të viteve 2015 dhe 2016, detyrimi është përmendur si detyrim ndaj z. M. M., jo më si subjekt ndërtues.

30.2. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni lidhur me shlyerjen e huas ndaj shoqërisë së ndërtimit, konstatohet se:

- më datë 08.01.2016, z. M. M. deklaroi se përgjatë vitit 2015 ka marrë në *cash* nga subjekti shumën 2.000.000 lekë dhe mbetet edhe shuma 720.000 lekë;

- sipas deklaratës noteriale të datës 03.01.2017 dhe sqarimeve të dhëna pranë Komisionit⁴³, z. M. M. deklaroi se subjekti i rivlerësimit ka likuiduar vlerën prej 2.700.000 lekësh, në dy këste – njërën përgjatë vitit 2015 në shumën 2.000.000 lekë dhe shumën 720.000 lekë përgjatë vitit 2016. Sipas z. M., vlera prej 2.700.000 lekësh është konsideruar debi personale ndaj tij, duke qenë se shoqëria e ndërtimit e kishte deklaruar të përfunduar objektin në dhjetor 2014 me faturë tatimore;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në seksionin e shpenzimeve të deklarueshme, investime për ndërtim objekti. Ndërkohë, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, deklaroi se është duke kryer ndërtim ambientit banimi dhe shumën 35.000 euro e ka xhiruar në bankë për firmën ndërtuese;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe private”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhëna të detajuara të shumave dhe mënyrës së shlyerjes së detyrimit ndaj firmës ndërtuese “{***}” dhe pjesës së mbetur të pashlyer, në vlerën 720.324 lekë;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lëvizjen e kryer në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank pasi ka marrë shumën nga D. P., te zbatuesi i firmës “{***}” ShPK. Në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme” deklaroi se: “Shpenzime janë edhe shuma në favor të firmës ndërtuese “{***}”. Kjo shumë u referohet detyrimeve financiare përfundimtare për ndërtimin e objektit të deklaruar dy kate + papafingo. [...]” dhe ka deklaruar shumën 720.000 lekë;
- në deklaratën *vetting*, për burimin e kësaj pasurie të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat familjare dhe kontratën e huas, datë 07.01.2014, me huadhënës z. D. P..

30.3. Nga sa ka rezultuar nga përmbajtja e këtyre akteve, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* detyrimin e shlyer ndaj shoqërisë ndërtuese [si burim krijimi të pasurisë së paluajtshme], ndërkohë që ka deklaruar huan në shumën prej 35.000 eurosh, marrë me kontratën e huas pa interes, datë 07.01.2014, z. D. P. me afat 10-vjeçar, që ka shërbyer si burim për shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “{***}” ShPK. Nga ana tjetër, z. M. M., në përgjigjet e dhëna Komisionit më datë 25.10.2018, sqaron se kjo shumë i detyrohej atij si debi personale – për shkak të parapagimit që ai ka kryer pasi objekti është deklaruar i përfunduar me faturë tatimore në dhjetor të vitit 2014.

30.4. Kuadri ligjor që normon procesin e deklarimit të pasurisë përcakton se objekt i deklarimit janë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj, sipas nenit 4, germa “dh” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Tashmë Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar të interpretimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerën provuese të deklaratave periodike dhe vlerës së tyre në raport me deklaratën *vetting* dhe plotësimin e tyre me saktësi dhe vërtetësi. Udhëzimi i ILDKPKI-së nr. 4095/2016⁴⁴, në pikën 7 përcakton detyrimin për deklarimin e burimit në momentin e krijimit të pasurisë. Po kështu, në formularin e deklarimit të pasurisë, në rubrikën “Deklarimi i

⁴³ Regjistruar me nr. {***} prot., datë 29.10.2018

⁴⁴ “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” - pika 7 parashikon: “[...] Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre [...]”.

pasurive”, thuhet se: *Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e dorëzimit të deklarimit të pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 [...] burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to [...], të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit [...]. Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë të shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.*

30.5. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën *vetting* detyrimin financiar të shlyer z. M. në vitin 2017 si burim të krijimit të pasurisë në momentin e krijimit. Nga ana tjetër, shlyerja e këtij detyrimi është deklaruar rregullisht në deklaratat e interesave privatë vjetorë/periodikë ashtu siç është deklaruar edhe huaja e marrë nga z. P. për të shlyer një pjesë të detyrimeve, në momentin kur e plotësimin të deklarimit të pasurisë [*vetting*], . Për rrjedhojë subjekti nuk ka qenë në kushtet e fshehtësisë së deklarimit të detyrimit të burimeve për krijimin e kësaj pasurie dhe pasaktësia në detajet që përbën burimin e krijimit të kësaj pasurie nuk është e tillë që të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm apo të ketë pasoja disiplinore për subjektin.

31. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se z. D. P. ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për t'i dhënë huan në vlerën 35000 euro dhe se argumenti i Komisionit për mungesë të të ardhurave për shkak të mosshpërndarjes së fitimit në formën e dividendit të shoqëria nuk qëndron.*

32. Subjekti parashton në ankim se i ka vënë në dispozicion Komisionit të gjithë materialin që mori nga z. D. P., përfshirë edhe deklaratën noteriale të këtij individi për përfitimin e të ardhurave të ligjshme dhe nga aktiviteti bujqësor përpara vitit 2000. Sipas subjektit, Komisioni i kishte të gjitha mundësitë të kryente verifikimet përkatëse dhe se huan e ka shlyer me kredinë e marrë në vitin 2018.

32.1. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni mbi huan e dhënë subjektit të rivlerësimit nga z. D. P., konstatohet kronologjia që vijon në lidhje me këtë hua.

- Më datë 07.01.2014, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë huaje [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me huadhënës z. D. P., për shumën 35.000 euro, pa interes dhe me afat shlyerjeje deri më datë 06.01.2024 (10 vite). Kjo hua është shlyer me kredinë e datës 05.06.2018⁴⁵. Subjekti i rivlerësimit ka kthyer shumën 4.450.000 lekë, e konvertuar në shumën 35.000 euro.
- Më 07.01.2014, z. D. P. ka depozituar 35.000 euro *cash* në llogarinë në euro të subjektit të rivlerësimit në Bankën Raiffeisen. Në përshkrimin e veprimit figuron: “D. P. *derdhje në llogari të ardhura nga biznesi*”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e huas me z. D. P. në rubrikën e detyrimeve financiare. Ky detyrim është deklaruar edhe në deklaratat e interesave privatë për vitin 2015, për vitin 2016 dhe në deklaratën *vetting*.
- Sipas QKB-së⁴⁶, z. D. P. figuron me status *aktiv* si person fizik i regjistruar më datë 01.01.2003, ortak zotërues i 50% të kuotave në shoqërinë “{***}” ShPK, regjistruar më

⁴⁵ Kontrata kredi bankare dhe hipotekë (Dhoma e Noterisë Lushnjë), nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.06.2018, me kredihënës/përfitues Raiffeisen Bank ShA dhe kredimarrës/hipotekues z. Çlirim Shahini dhe znj. E. Sh. (bashkëshortja), për dhënie të kredisë për qëllime konsumatore, në shumën 4.500.000 lekë, me afat 120 muaj.

⁴⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 24.04.2018.

13.12.2016, dhe administrator dhe ortak zotërues i 80% të kuotave të shoqërisë “{***}”ShPK, regjistruar më 06.04.2006. Kjo e fundit me status *i pezulluar*.

- Më datë 26.11.2018, z. D. P. ka dhënë deklaratën noteriale⁴⁷ sipas së cilës të ardhurat e tij burojnë nga aktiviteti privat që ai ka pasur duke filluar nga viti 1991 në fushën e transportit, tregtisë, e zdrukthtarisë, dhe duke vijuar me krijimin e shoqërisë “{***}”ShPK në vitin 2006.
- Sipas Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë⁴⁸, rezulton se z. D. P. është regjistruar si tatimpagues pranë kësaj drejtorie me: i) emër tregtar “{***}”dhe nuk ka detyrime tatimore, nuk ka kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të deklaruara e të palikuiduara. Sipas pasqyrave financiare për vitet 2016-2017, rezulton që i) nuk është shpërndarë dividend; ii) emër tregtar “{***}”ShPK me pasqyrat financiare për vitet 2006 – 2012 dhe 2014 – 2015, me dividend 0 lekë; iii) emër tregtar “D. P.”, me status pasiv prej 01.01.2003, me aktivitet marangoz. Me tatim të paguar për periudhën maj – dhjetor 2000, në shumën 40.000 lekë.
- Urdhër transferte në Bankën Raiffeisen, i datës 08.06.2018, sipas të cilit urdhëruesi Çlirim Shahini ka kaluar në llogarinë e D. P. shumën 4.450.000 lekë, me përshkrimin: “Likuidim huaje sipas kontratës noteriale, datë 07.01.2014, nr.{***} rep. dhe nr. {***} kol., të ardhura nga kredia”.

32.2. Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve, konstatohet se deklaratimet e z. D. P. se të ardhurat burojnë nga aktiviteti i ushtruar që në vitin 1991 deri në vitin 2006 dhe nga të ardhurat nga aktiviteti bujqësor nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion, duke mbetur në nivel deklarativ. Fakti që dividendi nuk rezulton i shpërndarë, nënkupton që sipas premisave ligjore të parashikuara nga ligji⁴⁹, shoqëria minimalisht nuk mbulon detyrimet (borxhet) me fitimet e saj. Ndërkohë, nuk rezultojnë as veprime të tjera në formën e transaksioneve bankare të shoqërisë “{***}”ShPK, me shuma të ngjashme ose të përafërta me vlerën e dhënë hua, që mund të ishin indicie për të vërtetuar burimin e shumës apo të një pjese të saj në vitin 2014.

32.3. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se z. D. P. ka të ardhura të ligjshme, rezulton i paprovuar. Në rrethanat faktike, subjekti i rivlerësimit nuk provon burimin e ligjshëm sipas detyrimeve të ligjit⁵⁰. Ndërkohë, pretendimi i subjektit se Komisioni “i kishte mundësitë për të verifikuar” burimin e të ardhurave të z. D. P. bie ndesh me konceptin e rivlerësimit pasi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, në zbatim të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sikurse është trajtuar edhe më sipër, i takon subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, në kushtet kur rezulton që Komisioni ka kryer gjithë hetimet e nevojshme nga të cilat z. P. ka rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të dhënë huan në janar 2014, subjekti i rivlerësimit kishte barrën e provës për të provuar të

⁴⁷ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

⁴⁸ Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 04.05.2018.

⁴⁹ Ligji nr. 9901/2008 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar parashikon në nenin 77 se: “1. Shoqëria mund t’u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit: a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj; b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim. [...]”. Në nenin 128, “Deklarimi i dividendit”, parashikohet se: “1. Dividendi është pjesa që i takon secilit aksionar nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme. [...] 4. Në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme mund të vendosë që shoqëria të mos shpërndajë dividendë ose që fitimi vjetor të mos u paguhet aksionarëve, që zotërojnë aksione të kategorive të veçanta, por këto shuma të përdoren për qëllime të tjera [...]”.

⁵⁰ Neni 32, pika 4 parashikon: “[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

kundërtën. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për financimin e pasurisë, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 35 mijë eurosh, të dhënë hua nga z. D. P. në vitin 2014.

33. *Mospasqyrimi i tepricave cash në deklaratat e interesave vjetorë/periodikë për vitet 2004 e deri në vitin 2010, sipas subjektit të rivlerësimit, përbëjnë një pakujdesi pasi janë konsideruar si teprica që nuk e kalonin vlerën 1.500.000 lekë. Burimi i të ardhurave ka qenë i mjaftueshëm, sipas raportit të ILDKPKI-së.*

33.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka trajtuar në ankim çështjen e mosdeklarimit të gjendjes *cash* në deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 – 2009, 2016 dhe në deklaratën *vetting*. Nga ana tjetër, nuk rezultoi që Komisioni të jetë shprehur apo të ketë mbajtur qëndrim mbi këtë çështje⁵¹. Për rrjedhojë, në kushtet kur mungon vlerësimi i Komisionit në vendimin përfundimtar, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi mos të shprehet për këtë çështje.

33.2. Në përfundim, lidhur me pasurinë e paluajtshme të ndodhur në Sarandë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të rremë, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë për vitet 2011, 2012 dhe 2013, kohën dhe veprimet e ndërmarra për ndërtimin e kësaj prone në raport me subjektin ndërtues “{***}” dhe natyrën e marrëdhënies pasurore të tij me z. D. R. . Subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për financimin e pasurisë pasi nuk provoi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 35 mijë eurosh, të dhënë hua nga z. D. P. në vitin 2014. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, geramat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për ndryshimin e vendimit të Komisionit lidhur me mosaplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk qëndrojnë.

II. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

34. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendime që lidhen me procesin e ndjekur nga Komisioni dhe nga DSIK-ja, duke pretenduar shkelje të procesit të rregullt ligjor. Këto dy institucione e kanë paragjykuar dhe kanë paracaktuar vendimin e dhënë. Sipas subjektit të rivlerësimit, është e pakuptimtë, e qëllimtë dhe në dëm të tij që DSIK-ja ka rishikuar raportin duke konstatuar *papërshtatshmëri* në vitin 2018 për fakte që kanë ndodhur shumë vite përpara se të përgatitej raporti, të cilat mund dhe duhej të ishin përfshirë në raportin e parë.

34.1. Nga aktet e përcjella, rezultoi se më datë 16.08.2018⁵², DSIK-ja ka ndryshuar konstatimin fillestar të datës 02.11.2017, duke u shprehur për *papërshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit në vazhdimin e detyrës. Rishikimi i raportit është bazuar në informacionin e ardhur prej institucioneve verifikuese. Nga leximi harmonik i dispozitave që rregullojnë kontrollin e figurës në ligjin nr. 84/2016, duke pasur parasysh analizën shteruese të përputhshmërisë së këtyre dispozitave me standardet e procesit të rregullt, shtjelluar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, bazuar edhe në opinionin ligjor

⁵¹ Subjekti u referohet rezultateve të hetimit administrativ. Aty Komisioni ka konstatuar se, sipas analizës financiare të kryer, subjekti rezultoi me diferencë negative për vitet 2011, 2012 dhe 2015, deklarimet e subjektit nuk përputhen dhe kursimet ndër vite sipas përlllogaritjes së subjektit nuk mund të merren në konsideratë në kushtet që nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit.

⁵² Shkresa nr. {***} prot., deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 08.01.2019, të KDZH-së.

të Komisionit të Venecias, rezulton që grupi i punës pranë DSIK-së ka përgjegjësi ligjore të luajë rol aktiv në kontrollin e figurës⁵³. Për më tepër, të gjitha organet e përfshira në procesin e rivlerësimit janë *instrumentale* në përmbushjen e mandatit të Komisionit dhe Kolegjit, në drejtim të marrjes së një vendimi përfundimtar mbi konfirmimin apo shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit nga ushtrimi i detyrës së tyre⁵⁴. Nga ana tjetër, rishikimi i raporteve fillestare të DSIK-së, pasi janë marrë informacione plotësuese nga institucionet verifikuese, është tashmë një praktikë e rregullt që i shërben verifikimit të plotë dhe të detajuar të kontrollit të figurës. Nga përmbajtja e vendimit, konstatohet se Komisioni i ka mbështetur konkluzionet për kontrollin e figurës në verifikimin që ka kryer vetë, bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, dhe jo vetëm në raportin e grupit të punës së DSIK-së. Konstatimi i grupit të punës së DSIK-së nuk ka qenë vendimtar në konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

34.2. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar si një gjykatë e jashtëzakonshme, në tejkallim të limiteve në ushtrimin e diskrecionit të dhënë nga ligji nr. 84/2016, dhe ka refuzuar marrjen e provave në favor të tij, që bie ndesh me parimin e një gjykimi të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.* Nga analiza e dokumentacionit në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes dhe ka bashkëpunuar me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për të verifikuar dhe saktësuar të dhënat e rezultuara gjatë hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për gjetjet e veta, si edhe ato që konstatohen nga raporti i rishikuar i DSIK-së. Pasi ka shqyrtuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për marrëdhëniet e tij me z. A. (N.) D. , Komisioni ka konkluduar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, pasi nuk ka renditur në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme si kontakt i papërshtatshëm. Siç është shtjelluar shprehimisht në vendim, sa i përket këtij aspekti të vlerësimit⁵⁵, Komisioni ka pasur në konsideratë përveç raporteve të DSIK-së, edhe aktet shkresore, përfshirë deklaramin e subjektit në funksion të kontrollit të figurës, dhe akte të tjera të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, dhe së fundmi, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti përgjatë procesit. Edhe nga përmbajtja e akteve të administruara në fashikull, përfshirë vendimin përfundimtar, nuk rezulton që Komisioni të ketë refuzuar marrjen e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Në analizë të sa më sipër, kundrejt pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit bazuar në prova dhe duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor në përputhje me garancitë kushtetuese, përfshirë edhe ato të shtjelluara në lidhje me procesin e rivlerësimit në mënyrë specifike nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, sipas Opinionit të Komisionit të Venecias⁵⁶.

- 35.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se masa disiplinore e shkarkimit është dhënë bazuar në hamendësime dhe opinione të DSIK-së, të miratuara verbërisht nga Komisioni. Sipas tij, DSIK-ja është një institucion i manipulueshëm, në varësi të ekzekutivit, që nuk ofron garanci për procesin e rregullt ligjor, punonjësit e kësaj strukture nuk janë të njohur dhe subjektit të rivlerësimit i lind e drejta të hamendësojë se këta punonjës mund të kenë pasur ndikime të karakterit personal që disfavorizojnë pozitën e tij. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim bie ndesh me themelet dhe dinamikën e procesit të rivlerësimit, teksa njëkohësisht*

⁵³ Shih paragrafin 36 të vendimit: http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php.

⁵⁴ Po aty, shih paragrafin 40 të vendimit.

⁵⁵ Paragrafi 28, faqe 5 e vendimit të Komisionit.

⁵⁶ CDL-AD(2016)036.

përpiqet të cenojë imazhin e institucioneve ndihmëse për shkak të kryerjes së detyrave të tyre ligjore.

35.1. Garancitë që ofrojnë institucionet ndihmëse kundrejt të drejtave themelore të individëve, në kuadër të procesit të rivlerësimit, pavarësisht nëse janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, janë analizuar në mënyrë shteruese në kuadër të ndryshimeve ligjore që paraprinë fillimin e procesit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, sjellim në vëmendje që në analizë të tagrave që do të merrnin organet ndihmëse në proces kundrejt garancive kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit për proces të rregullt, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

“[36]. Edhe në lidhje me procesin e kontrollit të figurës në vlerësimin e gjykatës ajo çfarë ka rëndësi në këtë gjykim është thelbi i kompetencave që ligji u ka njohur organeve të tjera të përfshira në proces, pra ato që lidhen me realizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave dhe të vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit. [...] Për këtë arsye është e rëndësishme që të garantohet se përfshirja e ekzekutivit në ligj dhe në praktikë duhet të kufizohet deri në shkallën që është ngushtësisht e domosdoshme për funksionimin efektiv të organeve të rivlerësimit (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias) [...].

[...]

[39]. Gjykata vlerëson se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses të gjitha materialet përkatëse. Në vlerësimin e saj, përdorimi i një grupi të tillë pune sipas nenit 36 të ligjit nuk shfaq probleme kushtetutshmerie nëse ai nuk përbëhet vetëm nga personeli i organeve të sigurisë, por përfshin edhe përfaqësues të KPK-së. [...] Gjykata, gjithashtu, rithekson se përdorimi i kontrolleve për qëllime të procesit të rivlerësimit, sipas dispozitave të kreut V të ligjit, duhet të jetë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e KPK-së dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollit të KA-së [...].”

35.2. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit rezulton të jetë pa baza dhe i pailustruar në asnjë fakt e provë që mund të ofrojë qoftë edhe tregues indirektë të arsyeve që motivojnë, sipas subjektit të rivlerësimit, konstatimin e DSIK-së për të. Përpos se një keqinformim, kjo qasje e subjektit është e papranueshme edhe në kontekstin profesional/etik.

- 36.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se deklaratimet e tij janë të sakta, sipas përcaktimeve të nenit Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, nuk ka fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklaratimit dhe ka plotësuar me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës; hetimi i Komisionit është i mangët dhe dashakeq. Në argumentet e tij në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka pasur kontakte, por njohje në distancë, në rrethana krejtësisht të rastësishme me z. A. (N.) D. . Subjekti pretendon se nuk ka qenë në dijeni të së kaluarës kriminale të z. D. dhe ky i fundit nuk ka pasur asnjë ndikim në funksionin e tij zyrtar. Subjekti parashtron se përdorimi i automjetit të z. D. ka qenë rastësor, kontakti me të ka qenë indirekt, jo i vazhdueshëm, dhe nuk mund të konsiderohet “si kontakt i papërshtatshëm”. Subjekti parashtron se përjashtohet mundësia që ai të dinte për dënimet e z. D. edhe nëse kjo do të ishte e vërtetë, duke qenë se ky i fundit ka ndryshuar emrin. Këtë fakt, subjekti e ka mësuar nëpërmjet Komisionit. Sipas subjektit, jo vetëm që ai nuk ka pasur dijeni për përfshirjen e z. D. në veprimtari kriminale, por as edhe të deklaratimeve të këtij të fundit më 23.04.2008, pasi ka pasur në hetim vetëm procedimin penal nr. {***} në ngarkim të z. S. M. . Me kërkesë të drejtuesit të prokurorisë, ka përpiluar vetëm vendimin e bashkimit të këtij procedimi me procedimin penal nr. {***}, bazuar në të dhëna minimale, si numrat e procedimeve dhe veprat penale objekt hetimi. Për më tepër, ai e njeh këtë individ me emrin A. D..*

36.1. Rezulton se në përgjigjet e pyetësorit standard të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka thënë:

*[...] Në datën 10.02.2013, kam marrë në përdorim mjetin, me targë {***}, mjet në pronësi të shtetasit A. D., lindur dhe banues në fshatin {***}, Sarandë, lëvizja në Greqi. Është N. D.. [...] Personat të cilët ju kam marrë mjetet në përdorim kanë qenë persona të njohur nga ana ime [...].*

Si rrjedhojë e këtij deklarimi, në përgjigje të kërkesës së Komisionit⁵⁷, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë⁵⁸ ka përcjellë informacion mbi tri rastet ku përfshihet z. N. [ose z. A.] D., person i cili rezulton me ndryshime në emër, duke bashkëlidhur edhe aktet e fashikujve penalë dhe konkretisht:

- procedimi penal nr. {***} dhe vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 15.12.2008 – për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal;
- procedimi penal nr. {***} (referuar kallëzimit nr. {***}, datë 27.08.2014), për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;
- kallëzimi me aktet nr. {***}, datë 14.08.2017, në ngarkim të A. (Th.) D. për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90/1 i Kodit Penal, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

36.2. Në aktet e përcjella nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, lidhur me procedimin penal nr. {***}, sipas procesverbalit për deklarimet nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime, të datës 23.04.2008, N. D. ka thënë: *[...] Ndërsa unë për vete jam kthyer nga Greqia para tre vjetësh, pasi kam dalë nga burgu ku kam vuajtur dënimin për 9 (nëntë) vjet për veprën penale të transportit të bimëve narkotike, për këtë unë kam marrë dhe ekspuls për të mos shkuar më në shtetin grek [...].* Më datë 19.09.2008, prokurori A. A., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale ndaj katër të pandehurve, përfshirë edhe N. D., për veprën penale të ndihmës së kalimit të paligjshëm të kufirit, të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal⁵⁹. Të katër janë dënuar përfundimisht nga Gjykata e Apelit Gjjirokastër [me vendimin nr. {***}, datë 09.06.2009].

36.3. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, për *pastrim të produkteve të veprës penale*, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur pushimin e çështjes, me argumentin se mungon ana objektive e kësaj vepre penale⁶⁰ [me vendimin e datës 19.06.2015]. Nga dosja e çështjes rezultojnë shkresa të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, në të cilat kërkohen të dhëna për hetimin në proces ndaj A. (N.) D., për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale⁶¹. Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit⁶², por edhe

⁵⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 16.10.2018, me lëndë “Kërkesë për dokumentacion”.

⁵⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 01.11.2018, me lëndë “Dërgohen të dhëna për procesin e rivlerësimit”.

⁵⁹ Procedimi penal nr. {***} ndaj z. S. M., i ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, është bashkuar me procedimin penal nr. {***}.

⁶⁰ Nga dosja penale rezulton se Drejtoria kundër Krimin Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka dyshime se përgjatë periudhës shkurt 2012 – 2014, z. A. D. ka përfutuar 87 transfertat në shumën 103.736 euro, kryesisht nga individë të ndryshëm nga Greqia, si dhe u ka dërguar nëpërmjet 16 transfertave personave të ndryshëm një vlerë totale prej 11.440 eurosh. Sipas të dyshuarit, këto të ardhura janë përfutuar nga bastet sportive. Me vendimin e pushimit, prokurori ka konkluduar se mungon ana objektive që kërkon neni 287 i Kodit Penal, pasi nuk rezulton që sasia e parave të jetë produkt i ndonjë vepre penale apo që i dyshuari të ketë kryer ndonjë vepër penale apo të ketë dijeni se paratë për të cilat janë kryer këto transaksione të jenë produkt i ndonjë vepre penale.

⁶¹ Korrespondenca e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me shtatë institucione të ndryshme, e konkretisht: me bankat e nivelit të dytë, me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit [dy shkresa], me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me Drejtorinë Rajonale të Tatim-Taksave, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe me Komisaratin e Policisë.

në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me z. A. D. ka pasur njohje në distancë dhe nuk i lidh asgjë. Vetëm një herë ka kontaktuar në mënyrë spontane nëpërmjet z. L. (V.) S., kur i ka marrë mjetin. Subjekti parashtron se nuk ka dijeni që ky individ ka qenë i arrestuar dhe proceduar penalisht në Greqi për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike, pasi dosja penale ku përmendet ky fakt është hetuar nga një prokuror tjetër.

36.4. Për sa ka rezultuar më lart, së pari A. (N.) D. ka pranuar të ketë qenë i dënuar në Greqi për veprën penale të transportit të bimëve narkotike. Së dyti, në vitet 2014 - 2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka regjistruar [dhe pushuar] procedimin penal në ngarkim të tij për pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale [neni 287 i Kodit Penal]. Duke qenë se kjo vepër përfshihet në nenin 3, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim “ligji nr. 10192/2009”), sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 15⁶³ e ligjit nr. 84/2016, A./N. D. përbën kontakt të papërshtatshëm për subjektin për shkak se procedimi penal në ngarkim të tij e bën atë “person të përfshirë në krimin e organizuar”.

36.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për njohje rastësore dhe mungesë dijenie të veprimtarinë kriminale të z. D. nuk janë bindëse. Së pari, ky shpjegim nuk përputhet me deklaratimet e tij në pyetësorin standard, ku ai është shprehur se ka përdorur automjete të personave të njohur prej tij. Së dyti, në vitin 2013, subjekti ka përdorur automjetin e një individi i cili më herët ishte hetuar për tre vjet [2008-2011] nga prokuroria ku subjekti ushtronte detyrën, duke përfutur nga ky individ pa asnjë shpërblim. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit që e lidh padijeninë me ndryshimin e emrit nga z. A. D., nuk është i besueshëm pasi vetë subjekti i rivlerësimit u referohet të dy emrave në përgjigjen e pyetësorit standard të Komisionit. Së treti, në vendimin e pushimit të procedimit penal në vitin 2015 [19.06.2015] (gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ka qenë drejtues i prokurorisë), thuhet se “shtetasi A. D. ka ndryshuar emrin nga “N.” në “A.” [...]”. E njëjta praktikë – referimi në të dy emrat [A. (N.) D.] – është ndjekur edhe në shkresat që subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë për të kërkuar informacion në kuadër të hetimit që po zhvillohej për këtë person për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale.

36.6. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka plotësuar saktësisht dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit të kontrollit të figurës, nuk qëndron. Z. D. rezulton të jetë person me precedentë penalë për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, jo vetëm në Greqi, sipas pohimit të tij, por edhe sepse në vitet 2014 – 2015 ka pasur një procedim penal nga prokuroria që drejtonte vetë subjekti, për një vepër penale të përfshirë në rrethin e veprave të krimit të organizuar e, për pasojë, cilësimin e tij si kontakt të papërshtatshëm për qëllim të ligjit nr. 84/2016 [shih paragrafin 36.4.] Duke qenë në dijeni të precedentëve penalë të z. A. D. për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar

⁶² Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për 3 çështje: (i) ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 09.12.2014, në ngarkim të z. A. D., me akuzën e pastrimit të produkteve të veprës penale, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal; (ii) ka ndikuar në procedimin penal në ngarkim të shtetasit A. D.; (iii) duket se ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

⁶³ Neni 3, pika 15 parashikon: “15. [...] “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 [...] me përjashtim të rastit kur është deklaruar “i pafajshëm” me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar” edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet [...]”.

(referuar procedimit penal të vitit 2014), në kushtet kur kishte përdorur mjetin e këtij të fundit në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte këtë të dhënë në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës, të plotësuar në vitin 2017. Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie goftë edhe rastësore, sikurse pretendon, në rubrikat e këtij formulari. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin e kontrollit të figurës dhe se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, pasi nuk ka renditur në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme si kontakt i papërshtatshëm, është i drejtë. Për rrjedhojë, konkluzioni i arritur nga Komisioni është në përputhje me përcaktimet e nenit Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës⁶⁴, kërkesat e Shtojcës 3, pjesa 5, germa “ç”⁶⁵ dhe nenet 38, pika 6, germa “a”⁶⁶ dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit dhe për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, është i drejtë.

37. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni është bazuar vetëm në deklaramet e N.D. për të konkluduar për veprimtarinë kriminale të tij në Greqi dhe kërkon nga Kolegji kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim administrimin dhe vlerësimin e vendimit nr. {***} të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe marrjen e akteve nga autoritetet greke të drejtësisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, z. N. D. nuk hyn në personat e përfshirë në krimin e organizuar pasi ai është dënuar në Shqipëri me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për kundërvajtje penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal⁶⁷. Sipas subjektit, nga ana e Komisionit, nuk është administruar asnjë akt që dokumenton përfshirjen z. D. në veprimtari të nivelit të krimit të organizuar në Greqi dhe thëniet e tij për dënimin atje nuk mund të konsiderohen. Subjekti parashtron se nuk ka asnjë konflikt në nënshkrimin e akteve administrative që lidhen me procedimin penal të vitit 2014 dhe se prokurori i çështjes në vendimin për pushimin e këtij procedimi penal në vitin 2015 nuk ka pasur asnjë ndikim prej tij. Sipas subjektit, Komisioni ka shkelur dispozitat ligjore në fuqi pasi procedimi penal nr. {***}/2008 është përpara datës 01.01.2012, të përcaktuar si datë fundore nga neni Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

37.1. Trupi gjyqësor i Kolegjit vëren se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për administrimin dhe vlerësimin e provave – vendimi nr. {***}, datë 09.06.2009 – dhe marrjen e akteve nga autoritetet greke të drejtësisë është trajtuar gjerësisht në hyrje të këtij vendimi, në paragrafin 16 e nënparagrafët e tij. Sikurse është trajtuar edhe atje, kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit nuk është e mbështetur në ligj, pasi të dhënat e vendimit të Gjykatës së Apelit janë të dokumentuara në tekstin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë [nr. {***}/2008], dhe administruar gjatë hetimit administrativ nga vetë Komisioni. Marrja e akteve nga autoritetet greke të drejtësisë nuk do të

⁶⁴ Neni Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë: “[...] 2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. [...] 4. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

⁶⁵ Shtojca 3, pjesa 5, germa “ç” parashikon: “Të dhëna për sigurinë” [...] ç. A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës suaj? Po – Jo Nëse po, ju lutem jepni shpjegime [...]”.

⁶⁶ Neni 38, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 6. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm janë kur: a) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme [...]”.

⁶⁷ Neni 297 i Kodit Penal parashikon: “Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

sillte ndonjë ndryshim në situatën e subjektit të rivlerësimit pasi konkluzioni për cilësimin e tij si kontakt i papërshtatshëm bazohet në procedimin penal të vitit 2014 nga autoritetet e drejtësisë shqiptare, për vepra penale të përfshira në përkufizimin e gjerë të krimit të organizuar, gjatë kohës kur vetë subjekti ishte drejtues i prokurorisë. Së fundmi, nga shqyrtimi i procedurës, përsëritja e marrjes së provave të administruara dhe të vlerësuara nga Komisioni nuk rezulton e nevojshme.

37.2. Për sa rezultoi edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, një ndër shkaqet e shkarkimit nga detyra për subjektin ka qenë mospërmbyllja e detyrimit ligjor të deklarimit të z. N. (A.) D. si kontakt i papërshtatshëm. Sikurse u analizua edhe më lart, Komisioni ka konstatuar që duke qenë në dijeni të procedimit penal në ngarkim të këtij individ në 2014 - 2015, për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, dhe meqenëse dy vjet më herët i kishte përdorur edhe automjetin, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte atë në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës në vitin 2017. Vendimi i Komisionit nuk rezulton të jetë bazuar vetëm në deklaratën e z. D. për dënimin e tij në Greqi apo në dënimin me vendim të formës së prerë në Shqipëri, të dyja ngjarje të ndodhura përpara vitit 2012. Konkluzioni i Komisionit mbështetet edhe në ngjarjet e viteve 2014 – 2015, në të cilat ky individ u hetua për përfshirje në vepra penale që lidhen me krimin e organizuar.

37.3. Në analizë të vendimit të Komisionit përkundër shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit për mungesë dijenie të identitetit apo njohje “spontanisht” të pronarit të një automjeti me të cilin udhëtoi jashtë shtetit, pa shpërblim, nuk janë bindëse. Në këtë konkluzion trupi gjykues ka në konsideratë që në kushtet kur hetonte një çështje penale, e cila më pas u bashkua me atë në ngarkim të z. D. e dy të tjerëve, mundësia teorike që subjekti i rivlerësimit ishte në errësirë të rrethanave në të cilat ishte takuar më parë me pronarin e automjetit⁶⁸, është thujse inekzistente. Nga ana tjetër, nëse pranohet për hir të argumentit pretendimi i mëvonshëm i subjektit të rivlerësimit se nuk njihej me pronarin e automjetit, qasja e tij e pretenduar në momentin e zgjedhjes së automjetit është alogjike, parë si në kontekstin e sigurisë së tij personale, ashtu edhe të përgjegjshmërisë profesionale. Nga ana e përgjegjësive profesionale, si prokuror, subjekti minimalisht duhet të ishte i vëmendshëm për të evituar pikërisht rrethanat të cilat kanë rezultuar që kanë ndodhur – përdorimin pa shpërblim të automjetit të një individ, i cili ka pasur disa përpjekje me drejtësinë edhe në njësinë administrative ku subjekti ushtron detyrën si anëtar i organeve të drejtësisë.

37.4. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se fakti që një prokuror hyn në marrëdhënie personale “favorizuese” me një individ dy vjet pasi hetimi trevjeçar ka përfunduar, përbën një situatë që afekton drejtpërdrejt besimin e publikut te drejtësia. Në cilësinë e përfaqësuesit të një institucioni të drejtësisë, sikurse organi i akuzës, subjekti i rivlerësimit kishte detyrim ligjor dhe etik të verifikonte çdo element që ndikon qoftë edhe teorikisht në ushtrimin e detyrës, nga njëra anë, apo në rastin më të pakët, perceptimin e publikut për zgjedhjet e kryera prej tij në jetën e tij private/jashtëgjyqësore. *Së treti*, në një qytet të vogël si Saranda, njohjet ndërmjet vendasve janë të konsoliduara dhe perceptimet e personit privat dhe funksionarit publik janë përherë të ndërthurura në këndvështrimin e një qytetari. Përdorimi i automjetit të një personi me probleme me drejtësinë shqiptare dhe greke⁶⁹, nga një magjistrat, drejtues i zyrës së prokurorisë që ka në juridiksion komunitetin ku të dy këta individë jetojnë, është përtej çdo debati një sjellje e cila ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Kjo situatë rëndohet duke marrë në konsideratë edhe faktin që procedimi penal ndaj këtij personi, për veprën penale të

⁶⁸ Paragrafi nr. 24 i vendimit të Komisionit.

⁶⁹ Shih më sipër pohimin e z. D. më 23.04.2008, sipas procesverbalit, riprodhuar në paragrafin 36.2, nga ku rezulton dënimi penal dhe masa administrative që ndalon kthimin e tij në Greqi.

pastrimit të produkteve të veprës penale, është pushuar nga prokuroria gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e drejtuesit. Ky element i vetëm faktik, qoftë edhe në mungesë më së paku të konfliktit të interesit, ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

37.5. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte kontaktin me z. A. (N.) D., duke dhënë edhe shpjegimin e pretenduar mbi njohjen dhe marrëdhëniet me të, deri në ditën e plotësimit të formularit të kontrollit të figurës. Për rrjedhojë, Komisioni ka konkluduar me të drejtë se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, pasi nuk ka deklaruar një kontakt të papërshtatshëm që është konstatuar nga prova të besueshme, në kuptim të nenit 38, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

III. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me cenimin e besimit të publikut të drejtësisë

- 38.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka evidentuar sjellje të subjektit të rivlerësimit në atë nivel që cenonjë besimin e publikut të drejtësisë. Lidhur me ankesën e z. B. Ç. për rastin e djalit të tij Ba.Ç., subjekti i rivlerësimit pretendon se hetimi i çështjeve penale në rastin në fjalë është kryer me objektivitet dhe procedimet penale janë hetuar në mënyrë korrekte, duke pasqyruar rrethanat reale të ngjarjes. Mangësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në ngritjen e akuzës dhe nuk kanë sjellë pasojë procedurale gjatë gjykimit apo në zgjidhjen ligjore të çështjes për të cilën janë deklaruar fajtorë katër të pandehurit⁷⁰. Vonesa në kryerjen e aktit të ekspertimit ka ndodhur për shkak të terapisë së të dëmtuarit, nevojitej dokumentacioni mjekësor nga jashtë dhe vonesa nuk ka sjellë asnjë pasojë tek i dëmtuari. Po kështu, subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk mund të paragjykonte se çështja penale nr. {***} do të amnistohet nga ligji për amnistinë⁷¹, dhe vepra penale e konsumuar nga personi nën hetim, F. K., është e provuar, pavarësisht se ka përfituar nga ky ligj.

38.1. Në drejtim të pretendimit mbi interpretimin e konceptit të cenimit të besimit të publikut, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje vendime të mëparshme të tij në të cilat është argumentuar se si subjektet e rivlerësimit kanë përgjegjësinë që edhe në jetën jashtëgjyqësore të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor, sjellje këto që afektojnë drejtpërdrejt besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Kolegji ka tanimë një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me aplikimin e masës disiplinore të shoqëruar dhe me cenimin e besimit të publikut⁷².

38.2. Sa u përket shkaqeve të ankimit që lidhen me konkluzionet e Komisionit bazuar në denoncimin e z. Ç.⁷³, nga analiza e procedimeve penale nr. {***} dhe {***} të vitit 2012, të përcjella nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë më datë 08.10.2018, konstatohen mangësitë e evidentuara edhe nga Komisioni në vendimin e dhënë ndaj subjektit të

⁷⁰ A. S., V. S., K. S. dhe B. (R.) Ç..

⁷¹ Ligj nr. 107/2012, datë 08.11.2012, “Për dhënie amnistie” – neni 5 “Pushimi i ndjekjes penale”, parashikon: “1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar duhet të pushojë për veprat penale të kryera deri në datën 30 shtator 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë. 2. Sipas kompetencës së dhënë nga Kodi i Procedurës Penale dhe në varësi të fazës apo të shkallës së procedimit penal, prokurori ose gjykata vendosin mosfillimin e çështjes penale apo pushimin e çështjes penale për veprat penale që amnistohen [...]”.

⁷² Shih vendimet nr. 28/2019, nr. 34/2019.

⁷³ Nr. {***} prot., datë 26.12.2017.

rivlerësimit⁷⁴. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka shkelur dispozitat e procedurës penale gjatë hetimit të kryer ndaj djalit të tij z. B. (R.) Ç. për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim dhe hetimit ndaj autorit të plagosjes së djalit të tij, gjatë kryerjes së veprës penale të vjedhjes. Sipas denoncuesit, është pushuar çështja e plagosjes së djalit të tij dhe ky i fundit është dërguar padrejtësisht për gjykim. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit qëndron. Konkretisht, rezulton se akti i ekspertimit mjeko-ligjor të z. Ç. për një incident të ndodhur më datë 17 mars 2012 është marrë nga subjekti vetëm më datë 21 janar 2013 – 10 muaj pas incidentit – ndërkohë që i njëjti element është përdorur si arsye për zgjatjen e afatit të hetimit. Përgjatë periudhës gjashtëmujore, 19.09.2012 – 19.02.2013, prokurori ka kërkuar dy herë zgjatjen e afateve të hetimit, me arsyetimin se nuk është administruar akti i ekspertimit mjeko-ligjor për të dëmtuarin R. Ç., ndërkohë që kërkesa për aktin e ekspertimit është përcjellë nga subjekti i rivlerësimit pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore vetëm në fund të periudhës së mësipërme, e konkretisht më datë 08.01.2013, apo përreth tri javë pasi është kërkuar për herë të fundit zgjatja e afatit. Po ashtu, qëndron konstatimi i Komisionit se në akte është shënuar emri i të pandehurit B. Ç. (referuar të dhënave të gjendjes civile), ndërkohë që nënshkrues është R. Ç., në procesverbalin e datës 04.06.2012 mungon nënshkrimi i oficerit të policisë gjyqësore. Së fundmi, edhe pse përshkrimi i gabuar i rrethanave të faktit ka ardhur nga OPGj-ja, subjekti nuk ka vepruar në dritën e përgjegjësisë së tij si prokuror⁷⁵. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe konkluzionet e tjera për parregullsitë e vërejtura në këtë procedim penal, kryer nga subjekti, qëndrojnë⁷⁶.

38.3. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se veprimet e tij nuk kanë shkaktuar pasoja procedurale apo të zgjidhjes së gjykimit, janë të pabazuara. Siç është shtjelluar më sipër, jo vetëm që procedimi penal rezulton të jetë karakterizuar nga gabime me pasoja procedurale – zgjatjen e afatit të hetimit, zvarritjen e zgjidhjes përfundimtare, mungesën e hetimit për qitësin e armës së dytë, konkluzionin se z. F. K. ka rrëshqitur – por edhe pretendimi i subjektit se palët nuk janë ankuar për veprimet nuk qëndron, në konsideratë të denoncimit që ka përbërë bazë të hetimit të mëtejshëm nga Komisioni. Me anë të këtyre veprimeve, subjekti ka demonstruar mangësi serioze në kryerjen e procedurave hetimore në rrethana të cilat ishin kryekëput në kontrollin e vetë atij. Ky vlerësim i trupit gjykues të Kolegjit është në përputhje edhe me përcaktimet e nenit 73⁷⁷ të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin

⁷⁴ Shih faqe 22 – 25 të vendimit.

⁷⁵ Në procesverbal është pasqyruar gabimisht se njëri nga të pandehurit, F.K., ka rrëshqitur, gjë që bie ndesh me deklarinimin e tij. Në procesverbalin e datës 18.03.2012, për marrjen e të dhënave nga oficeri i policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë [S. B.] personi nën hetim, F. K., është shprehur: “[...] Unë kam dashur t’i tremb dhe kam shtirë në ajër një herë dhe një herë kam dashur që t’u shpoj gomat, dhe (ka një paragraf bosh) nuk di të kem qëlluar drejt dhe të kem qëlluar ndonjë person pasi ishte dhe natë dhe unë për këtë fakt kam njoftuar policinë [...]”. Në informacionin për referimin e veprës penale të prokurorit, oficeri i policisë gjyqësore S. B. është shprehur: “[...] Në këtë moment F. ka qëlluar në fillim në ajër me armën e zjarrit dhe më pas ka qëlluar në drejtim të gomave të mjetit, por ka rrëshqitur dhe nuk e di se ku kanë shkuar saçmet e çiftes [...]”.

⁷⁶ Shih konstatimet në faqet 22-25 të vendimit të Komisionit që kanë të bëjnë me konstatim të mungesës së fotografive të vendit të ngjarjes, mungesës së veprimeve hetimore në drejtim të identifikimit të armës dhe qitësit të dytë të konstatuar nga ekspertimi tekniko-balistik i vendit të ngjarjes, datë 23.04.2012, sipas gëzhgojave të gjetura në vendin e ngjarjes, dhe shkeljen e dispozitës procedurale që kërkon t’u njoftohet të pandehurve zgjatja e afatit të hetimit (neni 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale).

⁷⁷ Neni 73, pika 2 parashikon: “[...] Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën [...]”. Për një shtjellim të mëtejshëm të elementeve të ndryshme që duhet të analizohen në kontekstin e vlerësimit profesional, shih edhe paragrafin 16.10 të vendimit të Kolegjit:

http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendimi-i-SR-Alfred-Gjoni-i-anonimizuar_compressed.pdf

e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për sa i përket aftësisë së subjektit për të kryer detyrën me cilësi dhe brenda afateve.

38.4. Në përmbledhje të sa më sipër, referuar mangësive të evidentuara në shqyrtimin e fakteve të denoncimit, së bashku me mangësitë e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut pasi:

i) fakti që subjekti i rivlerësimit ka përdorur automjetin e një personi me precedentë penalë, ndaj të cilit gjatë kohës që prokuroria që drejtohej prej tij, ka pushuar procedimin për pastrimin e produkteve të veprës penale, përbën sjellje që minimalisht cenon besimin e publikut te drejtësia;

ii) nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* e përgjatë hetimit administrativ deri në mars 2019 përdorimin e të paktën një pjese të pronës si njësi akomoduese;

iii) faktet e sjella në vëmendje nga denoncimi dhe të provuara gjatë hetimit administrativ të procedimit penal objekt i denoncimit pasqyrojnë gabime procedurale që tregojnë mangësi profesionale, mungesë angazhimi dhe përgjegjshmërie në përfaqësimin e interesit publik që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut për organet e drejtësisë.

38.5. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të parashtruara në ankim, si dhe shqyrtoi provat dhe aktet e administruara gjatë hetimit nga Komisioni për këtë çështje, vlerësoi se:

○ *në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë*, për objektin prej dy katesh, plus papafingo, i ndodhur në Sarandë, me sipërfaqe 387 m², ndërtuar mbi objektin ekzistues me 3 kate, në pronësi të z. D. R. :

a) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të rremë, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë për vitet 2011, 2012 dhe 2013, kohën dhe veprimet e ndërmarra për ndërtimin e kësaj prone në raport me subjektin ndërtues “{***}” dhe natyrën e marrëdhënies pasurore të tij me z. D. R. ;

b) subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për financimin e pasurisë pasi nuk provon burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 35 mijë eurosh, të dhënë hua nga z. D. P. në vitin 2014.

Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, geramat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016;

○ *në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës*, subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës pasi nuk ka deklaruar një kontakt të papërshtatshëm që është konstatuar nga prova të besueshme, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016;

○ *në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të pasurisë, figurës dhe analizës së denoncimit për çështjen e z. B. Ç.*, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut pasi:

i) fakti që subjekti i rivlerësimit ka përdorur automjetin e një personi me precedentë penalë, ndaj të cilit gjatë kohës që prokuroria që drejtohej prej tij, ka pushuar procedimin për pastrimin e produkteve të veprës penale, përbën sjellje që minimalisht cenon besimin e publikut te drejtësia;

ii) nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* e përgjatë hetimit administrativ deri në mars 2019 përdorimin e të paktën një pjese të pronës si njësi akomoduese;

iii) faktet e sjella në vëmendje nga denoncimi dhe të provuara gjatë hetimit administrativ të procedimit penal objekt i denoncimit, pasqyrojnë gabime procedurale që tregojnë mangësi profesionale, mungesë angazhimi dhe përgjegjshmërie në përfaqësimin e interesit publik, që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut për organet e drejtësisë.

39. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga nenet D, pikat 3 dhe 5 dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriteret e kontrollit të pasurisë dhe të figurës, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova, dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 124, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.10.2020.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi